FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 157

Tiranë – E enjte, 4 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 2.9.2025	Për lirim nga detyra	20795
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 2.9.2025	Për lirim nga detyra	20795
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 2.9.2025	Për lirim nga detyra	20795
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 2.9.2025	Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025	20795
Urdhër i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it nr. 99, datë 25.8.2025	Për delegimin e kompetencave	20796
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 805, datë 14.8.2025	Për miratimin e rregullave të detajuara për praktikat enologjike, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë	20797
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 806, datë 14.8.2025	Për rregullat shtesë specifike për etiketimin e produkteve të verës	20819
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 807, datë 14.8.2025	Për përcaktimin e formës së certifikatës për eksport për produktet e verës	20830
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 829, datë 25.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë	20836

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 830, datë 25.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	20838
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 837, datë 28.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	20839
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 838, datë 28.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	20842
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 839, datë 28.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Estonisë.....	20844
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 840, datë 28.8.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	20847
Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1030, datë 2.9.2025	Për delegimin e kompetencave.....	20849
Urdhër i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1031, datë 2.9.2025	Për zëvendësimin e përkohshëm për nënshkrimin e dokumenteve në emër të sekretarit të përgjithshëm.....	20849

VENDIM
Nr. 480, datë 2.9.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Romina Kuko, zëvendësministër i Brendshëm, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 481, datë 2.9.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ceno Klosi, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 482, datë 2.9.2025

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ilva Gjuzi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 483, datë 2.9.2025

PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie shpërblimi personelit, punonjës shtetërorë, të angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë verës së vitit 2025.

2. Shpërblehen punonjësit e:

a) Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

b) Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

c) Policisë së Shtetit;

ç) Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;

d) Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki.

3. Punonjësit e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë shpërblim, sipas kohëzgjatjes së angazhimit, si më poshtë vijon:

a) Për angazhim me kohëzgjatje, nga 1 (një) deri në 7 (shtatë) ditë, jepet shpërblim në masën e 1 (një) page mujore;

b) Për angazhim me kohëzgjatje, nga 8 (tetë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, jepet shpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore;

c) Për angazhim me kohëzgjatje 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë e më shumë jepet shpërblim në masën e 3 (tri) pagave mujore.

4. Shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mujore bruto të punonjësit të angazhuar në operacionet e shuarjes së zjarreve.

5. Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2025.

6. Në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, në shpenzimet korrente, shtohet fondi prej 193 140 098 (njëqind e nëntëdhjetë e tre milionë e njëqind e dyzet mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, përkatësisht 145 809 950 (njëqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë në programin buxhetor "Forcat e luftimit", 43 408 127 (dyzet e tre milionë e katërqind e tetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë në programin buxhetor "Mbështetja e luftimit" dhe 3 922 021 (tre milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e njëzet e një) lekë në programin buxhetor "Emergjencat civile".

7. Në buxhetin e Ministrisë së Brendshme, në shpenzimet korrente, shtohet fondi prej 69 615 100 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind) lekësh në programin buxhetor "Policia e Shtetit".

8. Efekti financiar për strukturën e përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2025 për Ministrinë e Brendshme.

9. Efekti financiar për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 99, datë 25.8.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", neneve 22, pika 3, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, koordinatorit pranë drejtorit të përgjithshëm, znj. Marçela Shahini, për shkak të mungesës me arsye të titullarit.

2. Delegimi i kompetencave përfshin vetëm fushën e veprimtarisë administrative të institucionit.

3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë do të ushtrohen për periudhën nga data 26.8.2025 deri më datë 29.8.2025.

4. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerjen vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

5. Për vendimmarrje të një rëndësie të veçantë, apo çështje të caktuara, znj. Marçela Shahini duhet të marrë miratimin paraprak nga drejtori i përgjithshëm nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

6. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, koordinatori pranë drejtorit të përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara, apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t'ia bëj të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

7. Ngarkohet znj. Marçela Shahini, koordinator pranë drejtorit të përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Linda Pustina

URDHËR
Nr. 805, datë 14.8.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PRAKTIKAT ENOLOGJIKE, PROTOKOLLET DHE METODAT E ANALIZAVE PËR PRODUKTET E PËRFTUARA NGA PËRPUNIMI I RRUSHIT PËR VERË[1]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 13, të ligjit nr. 86, datë 22.12.2022, "Për vreshtarinë dhe verën",

URDHËROJ:

Neni 1
Qëllimi

1. Ky urdhër ka për qëllim përcaktimin e rregullave të detajuara lidhur me praktikat enologjike të autorizuara, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e përftuara nga përpunimi i rrushit për verë, në plotësim të rregullave të përcaktuara në nenin 13 dhe në nenin 14, të ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

2. Rregulla dhe kërkesat për pasurimin, acidifikimin dhe deacidifikimin, si dhe kufizimet për praktikat enologjike bazohen në standardet ndërkombëtare të prodhimit të verës të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës, këtu e në vijim "OIV".

Neni 2
Përkufizime

1. Për qëllim të zbatimit të këtyre rregullave, termat e përdoruar në këtë urdhër kanë kuptimin e dhënë në nenin 2, të ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

2. "Eksperiment" është një veprim ose veprime të kryera në kuadrin e një projekti kërkimor të mirëpërcaktuar me një protokoll të vetëm eksperimental.

3. Termi "ligj" është përdorur për ligjin nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

Neni 3
Kufijtë e pasurimit

1. Në zona të caktuara të rritjes së rrushit, për shkak të kushteve klimatike që kanë krijuar këtë nevojë, lejohet të shtohet fortësia alkoolike natyrale sipas vëllimit të rrushit të freskët, mushtit të rrushit, mushtit të rrushit në fermentim, verës së re ende në fermentim dhe verës së përftuar nga varietetet e rrushit për verë të klasifikuara sipas nenit 10 të ligjit.

2. Rritja e fortësisë alkoolike natyrale sipas vëllimit arrihet me anë të praktikave enologjike të referuara në nenin 4 të këtij urdhri dhe nuk duhet të kalojë 1,5% sipas volumit.

3. Në vitet kur kushtet klimatike kanë qenë veçanërisht të pafavorshme, prodhuesit e verës mund të kërkojnë që kufiri i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni të rritet me 0,5%. Në këtë rast, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të

[1] Ky urdhër është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007", të ndryshuar. Numri CELEX 32013R1308, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f. 671–854;

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/934, datë 12 mars 2019, "Për plotësimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me zonat e verës ku mund të rritet fortësia alkoolike, praktikat e autorizuara enologjike dhe kufizimet e zbatueshme për prodhimin dhe konservimin e produkteve të rrushit për verë, përqindjen minimale të alkoolit për nënproduktet dhe asgjësimin e tyre, dhe publikimin e dosjeve OIV", të ndryshuar. Numri CELEX 32019R0943, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 149, datë 7.6.2019, f. 1–52;

- Rregulloren (BE) 2021/2117 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 2 dhjetor 2021, "Për ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore", (BE) nr. 1151/2012, "Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore", Rregullores (BE) nr. 251/2014 "Për përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë të produkteve të verës së aromatizuar", dhe Rregullores (BE) nr. 228/2013, "Për masat specifike për bujqësinë në rajonet më të largëta të Unionit". Numri CELEX 32021R2117, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 435, datë 6.12.2021, f. 262–314;

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2022/68, datë 27 tetor 2021, "Për ndryshimin e Rregullores së Deleguar (BE) 2019/934, që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për sa u përket praktikave enologjike të autorizuara". Numri CELEX 32022R0068, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 12, datë 19.1.2022, f. 1–29.

Vitivinikulturës, brenda një periudhe 1-mujore (njëmujore) nga data e dorëzimit të një kërkese të tillë, ministri miraton aktin normativ për rritjen e fortësisë për zonat përkatëse të kultivimit të vreshtave për verë.

Neni 4
Proceset e pasurimit

1. Rritja e fortësisë alkoolike natyrale sipas vëllimit, e parashikuar në nenin 3 të këtij urdhri, bëhet vetëm:

a) për rrushin e freskët, mushtin e rrushit në fermentim ose verën e re ende në fermentim, duke shtuar musht rrushi të përqendruar ose musht rrushi të përqendruar të korrigjuar;

b) për mushtin e rrushit, duke shtuar musht rrushi të përqendruar ose musht rrushi të përqendruar të korrigjuar, ose duke e përqendruar pjesërisht nëpërmjet përdorimit të osmozës së kundërt;

c) për verën, me përqendrim të pjesshëm nëpërmjet ftohjes.

2. Nëse vera ose mushti i rrushit pasurohet me musht rrushi të përqendruar ose musht rrushi të përqendruar të korrigjuar përjashtohet përdorimi i osmozës së kundërt ose përqendrimi i pjesshëm përmes ftohjes.

3. Shtimi i mushtit të rrushit të përqendruar ose i mushtit të rrushit të përqendruar të korrigjuar nuk duhet të ketë efekt në rritjen e vëllimit fillestar të rrushit të freskët të shtypur, mushtit të rrushit, mushtit të rrushit në fermentim ose verës së re ende në fermentim me më shumë 6,5%.

4. Përqendrimi i mushtit të rrushit ose i verës që u nënshtrohet proceseve të përmendura në pikën 1 të këtij neni nuk duhet të ketë efektin e uljes së vëllimit fillestar të këtyre produkteve me më shumë se 20%.

5. Proceset e përmendura në pikat 1 dhe 4 të këtij neni nuk rrisin fortësinë alkoolike totale sipas vëllimit të rrushit të freskët, mushtit të rrushit, mushtit të rrushit në fermentim, verës së re ende në fermentim ose verës, përtej kufijve të lejuar, që përcaktohen në varësi të zonave të prodhimit të rrushit për verë, në përputhje me pikën 6 të nenit 10 të ligjit dhe në çdo rast jo më shumë se 13,5%.

6. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 5 të këtij neni, fortësia alkoolike totale në vëllim e produkteve të përmendura në atë pikë mund të rritet përtej kufirit prej 13,5% dhe deri në një nivel sipas përcaktimeve, kushteve dhe rregullave të përdorura nga prodhuesit e verërave me emërtim origjine të mbrojtur ose tregues gjeografik të mbrojtur, të miratuara nga Komisioni i Verës.

Neni 5
Acidifikimi dhe deacidifikimi

1. Rrushi i freskët, mushti i rrushit, mushti i rrushit pjesërisht i fermentuar, vera e re ende në fermentim dhe vera mund t'i nënshtrohen acidifikimit dhe deacidifikimit.

2. Acidifikimi i produkteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të kryhet vetëm deri në një kufi prej 4g/l, të shprehur si acid tartrik, ose 53.3 miliekuivalentë për litër.

3. Deacidifikimi i verërave mund të kryhet vetëm deri në një kufi prej 1g/l, i shprehur në acid tartrik, ose 13,3 miliekuivalentë për litër.

4. Mushti i rrushit i parashikuar për përqendrim mund të jetë pjesërisht i deacidifikuar.

5. Acidifikimi dhe pasurimi, si dhe acidifikimi dhe deacidifikimi i të njëjtit produkt janë procese që përjashtojnë njëra-tjetrën.

Neni 6
Proceset

1. Asnjë nga proceset e përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të këtij urdhri, me përjashtim të acidifikimit dhe deacidifikimit të verërave, nuk autorizohet nëse nuk kryhet në kohën kur rrushi i freskët, mushti i rrushit, mushti i rrushit në fermentim ose vera e re ende në fermentim shndërrohen në verë ose në ndonjë pije tjetër të sektorit të verës, e destinuar për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit, përveç verës shkumbëzuese ose verës së gazifikuar shkumbëzuese.

2. Këto procese të autorizuara kryhen në një veprim të vetëm. Ato mund të kryhen në më shumë se një veprim, ku kjo përmirëson vinifikimin e produkteve në fjalë. Në raste të tilla, kufizimet e përcaktuara në nenet 3, 4 dhe 5 të këtij urdhri, zbatohen për të gjitha veprimet në fjalë.

3. Secili nga proceset e parashikuara në nenet 3, 4, 5 dhe 7 të këtij urdhri, regjistrohet në regjistrin e hyrjeve dhe të daljeve, të parashikuar në nenin 16 të ligjit. Detyrimi për regjistrim zbatohet edhe për sasitë e mushtit të përqendruar, mushtit të

përqendruar të korrigjuar që mbahen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend me rrushin e freskët, mushtin e rrushit, mushtin e rrushit në fermentim ose verën e hapur, gjatë ushtrimit të profesionit nga persona ose grupe personash fizikë ose juridikë, në veçanti prodhues, mbushës shishesh, përpunues dhe tregtarë.

4. Secili nga proceset e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij urdhri, shënohet në dokumentin shoqërues, të parashikuar në nenin 38 të ligjit, i cili shoqëron produktet që i janë nënshtruar atyre proceseve kur vihen në qarkullim.

5. Proceset e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij urdhri nuk kryhen pas datës 1 janar.

6. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, përqendrimi me ftohje, acidifikimi dhe deacidifikimi i verërave mund të kryhen gjatë gjithë vitit.

Neni 7
Procesi i dealkoolizimit

1. Lejohet, për të reduktuar një pjesë ose thuajse gjithë përmbajtjen e etanolit në produktet rrushit për verë, të përkufizuara në nënpikën 20.1 dhe nënpikat 20.4 deri 20.9, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, secili nga proceset e dealkoolizimit të listuara më poshtë, qoftë i përdorur më vete ose i kombinuar me proceset e tjera të listuara të dealkoolizimit:

a) avullim i pjesshëm nën vakum;

b) teknika membranore;

c) distilim.

2. Proceset e dealkoolizimit të përdorura nuk duhet të rezultojnë në defekte organoleptike të produktit të rrushit për verë. Eliminimi i etanolit në produktet e rrushit për verë nuk bëhet së bashku me rritjen e përmbajtjes së sheqerit në mushtin e rrushit.

3. Proceset e dealkoolizimit duhet t'i njoftohen paraprakisht dhe me shkrim autoritetit përgjegjës të kontrollit zyrtar, të paktën 5 ditë pune para fillimit të tyre.

4. Kupazhimi, ose përzierja e një vere me një verë pjesërisht të dealkoolizuar, ose me një verë të dealkoolizuar nuk lejohet, nëse produkti që rezulton nga ky kupazhim do të quhet "verë" ose "verë pjesërisht e dealkoolizuar".

5. Praktikat e tjera enologjike mund të zbatohen në verërat e dealkoolizuara ose pjesërisht të dealkoolizuara.

Neni 8
Praktikat enologjike të autorizuara

1. Praktikat enologjike të autorizuara dhe kufizimet përkatëse, të zbatueshme për prodhimin dhe ruajtjen e produkteve të rrushit për verë, në përputhje me nenet 13 dhe 14 të ligjit, përcaktohen në shtojcën I të këtij urdhri. Tabela 1 e pjesës A, të shtojcës I të këtij urdhri, përcakton proceset enologjike të autorizuara, si dhe kushtet e kufijtë e përdorimit të tyre. Tabela 2 e pjesës A, të shtojcës I, të këtij urdhri përcakton substancat enologjike të autorizuara, si dhe kushtet e kufijtë e përdorimit të tyre.

2. Kodi i praktikave enologjike të OIV-së, referuar në kolonën 2, të tabelës 1, dhe në kolonën 3, të tabelës 2, të pjesës A, të shtojcës I, të këtij urdhri, konsultohet publikisht në faqen zyrtare të internetit të Organizatës Ndërkombëtare të Rrushit dhe Verës (OIV).

3. Pjesa B, e shtojcës I, të këtij urdhri përcakton përmbajtjen maksimale të dyoksidit të squfurit të verërave.

4. Pjesa C, e shtojcës I, të këtij urdhri përcakton përmbajtjen maksimale të acidit të avullueshëm të verërave.

5. Pjesa D, e shtojcës I, të këtij urdhri përcakton rregullat për ëmbëlsimin.

Neni 9
Përdorimi eksperimental i praktikave enologjike të reja

1. Për qëllime të arritjes së rezultateve eksperimentale, të parashikuara në pikën 4, të nenit 13 të ligjit, lejohet përdorimi i disa praktikave, ose proceseve enologjike, që nuk parashikohen në ligj ose në këtë urdhër, për një maksimum prej 5 (pesë) vjetësh, me kusht që:

a) Praktikat dhe proceset në fjalë:

i. marrin në konsideratë mbrojtjen e shëndetit të njeriut;

ii. marrin në konsideratë rrezikun e mundshëm të keqinformimit të konsumatorëve, për shkak të perceptimit që kanë për produktin dhe pritshmërive të tyre përkatëse, duke pasur parasysh disponueshmërinë dhe realizueshmërinë e mjeteve informuese për të përjashtuar rreziqe të tilla;

iii. lejojnë ruajtjen e karakteristikave natyrale dhe thelbësore të verës e nuk shkaktojnë një ndryshim thelbësor në përbërjen e produktit në fjalë;

iv. sigurojnë një nivel minimal të pranueshëm të kujdesit për mjedisin;

v. respektojnë rregullat e përgjithshme për praktikat enologjike dhe rregullat e përcaktuara në nenet 13, 14 dhe 15 të ligjit dhe nenet 3, 4, 5 dhe 6 të këtij urdhri.

b) Palët e interesuara që paraqesin kërkesë në ministri për t'u pajisur me autorizim për të përdorur praktika enologjike eksperimentale, midis të tjerave duhet të deklarojnë:

i. që veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij neni;

ii. vendin ku kryhet eksperimenti;

iii. sasinë e verës që i nënshtrohet trajtimit çdo vit;

iv. një raport përmbledhës të eksperimentit që tregon arsyet e kërkesës për autorizim.

c) Praktika dhe procese të tilla zbatohen për sasi që nuk i kalojnë 50 000 hektolitra në vit, për çdo eksperiment.

ç) Para fillimit të eksperimentit dhe pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, në autorizim përcaktohen kriteret, kushtet dhe afatet për zhvillimin e eksperimentit ku ndër të tjera përcaktohet:

i. periudha e zhvillimit të eksperimentit;

ii. data në të cilën do të fillojë;

iii. lloji dhe cilësia e produktit që do t'i nënshtrohet trajtimit dhe identifikimi i enëve të produkteve që i nënshtrohen eksperimentit.

d) Proceset regjistrohen në dokumentin shoqërues të parashikuar në nenin 38 të ligjit dhe në regjistrin hyrjeve dhe të daljeve të parashikuar në nenin 16 të ligjit.

2. Produktet e përftuara nga përdorimi eksperimental i praktikave dhe i proceseve të tilla enologjike mund të dalin në treg.

3. Brenda 3 (tre) muajsh, pas përfundimit të afatit të referuar në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, prodhuesi që ka zbatuar përdorimin eksperimental të praktikave të reja enologjike duhet të dorëzojë në ministri një raport mbi eksperimentin dhe rezultatet përkatëse, të cilin ministria e miraton dhe e publikon.

Neni 10

Praktika enologjike të zbatueshme për verërat e gazuara shkumbëzuese

Përveç praktikave enologjike dhe kufizimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 13, 14 dhe 15 të ligjit, nenet 3, 4, 5 dhe 6 dhe shtojcën I të këtij urdhri, praktikat specifike enologjike të autorizuara dhe kufizimet, duke përfshirë pasurimin, acidifikimin dhe deacidifikimin për verërat e gazuara shkumbëzuese, verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore dhe verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike, të përkufizuara në nënpikat 20.4, 20.5, 20.6, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, parashikohen në shtojcën II, të këtij urdhri.

Neni 11

Praktika enologjike të zbatueshme për verërat e fortifikuara likeroze

1. Përveç praktikave enologjike, të përcaktuara në shkronjën "ç", të nënpikës 20.3, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit dhe kufizimeve të përgjithshme, "Verë e fortifikuar likeroze me emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur" është produkti të cilit i është shtuar:

a) secili nga produktet e listuara në shkronjën "ç"/"i" të nënpikës 20.3, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, veçmas ose në kombinim; ose

b) një ose më shumë nga produktet e mëposhtme:

i. alkool nga vera ose alkool nga rrushi i thatë me një fortësi alkoolike efektive jo më pak se 95% në volum dhe jo më shumë se 96% në volum;

ii. pije alkoolike të distiluara nga vera ose nga bërsia e rrushit, me një fortësi alkoolike efektive jo më pak se 52% në volum dhe jo më shumë se 86% në volum;

iii. pije alkoolike të distiluara nga rrushi i tharë, me një fortësi alkoolike efektive jo më pak se 52% në volum dhe më pak se 94,5% në volum; dhe

c) një ose më shumë nga produktet e mëposhtme, sipas rastit:

i. musht rrushi pjesërisht i fermentuar, i përftuar nga rrushi i tharë;

ii. musht rrushi i përqendruar i përftuar nga veprimi i drejtpërdrejtë i nxehtësisë, i cili, me përjashtim të këtij veprimi, përputhet me përkufizimin e mushtit të rrushit të përqendruar;

iii. musht rrushi i përqendruar;

iv. një kombinim i një prej produkteve të listuara në shkronjën "b" të kësaj pike me mushtin e rrushit në fermentim, mushtin e rrushit, ose përzierjen e tij me verën për disa verëra të fortifikuara likeroze, me emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur.

2. Përveç praktikave enologjike dhe kufizimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 13, 14 dhe 15 të ligjit, nenet 3, 4, 5 dhe 6, dhe shtojcën I të këtij urdhri, praktikat specifike enologjike të autorizuara dhe kufizimet për verërat e fortifikuara likeroze, të përkufizuara në nënpikën 20.3, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, parashikohen në shtojcën III, të këtij urdhri.

Neni 12
Kupazhimi

1. Në përputhje me kuptimin e termit "kupazhim", të përkufizuar në pikën 4, të nenin 2, të ligjit, përzierja e llojeve të ndryshme verërash përfshin përzierjen e verërave ose mushteve me origjinë të ndryshme, varieteteve të ndryshme hardhie, viteve të ndryshme vjeljeje ose kategorive të ndryshme të verërave ose mushtit.

2. Kategoritë e mëposhtme konsiderohen si kategori të ndryshme të verërave ose mushtit:

a) vera e kuqe, vera e bardhë dhe mushtet ose verërat e përshtatshme për prodhimin e njërës prej këtyre kategorive të verërave;

b) verërat pa emërtim origjine të mbrojtur dhe verërat pa tregues gjeografik të mbrojtur, verërat me emërtim origjine të mbrojtur (EOM) dhe verërat me tregues gjeografik të mbrojtur (TGJM), si dhe mushtet ose verërat e përshtatshme për të prodhuar një nga këto kategori verërash.

3. Për qëllimet pikës 2 të këtij neni, vera rozë (trëndafil) konsiderohet si verë e kuqe.

4. Proceset e mëposhtme nuk konsiderohen kupazhim:

a) pasurimi me shtim mushti rrushi të përqendruar ose mushti rrushi të përqendruar të korrigjuar;

b) ëmbëlsimi.

Neni 13
Rregulla të përgjithshme për përzierjen dhe kupazhimin

1. Një verë mund të përftohet nga përzierja ose kupazhimi vetëm kur përbërësit e asaj përzierjeje ose kupazhi kanë karakteristikat e kërkuara për përftimin e verës dhe janë në përputhje me ligjin dhe këtë urdhër.

2. Kupazhimi i një vere të bardhë pa EOM/TGjM me një verë të kuqe pa EOM/TGJM nuk mund të prodhojë një verë rozë.

3. Rregullimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni nuk përjashton kupazhime ku produkti përfundimtar është menduar për përgatitjen e një *cuvée*-je, siç përcaktohet në shkronjën "f", të pikës 10, të nenit 2 të ligjit, ose i destinuar për prodhimin e verërave pjesërisht të gazuara.

Neni 14
Pastërtia dhe specifikimet identifikuese të substancave të përdorura në praktikat enologjike

Specifikimet e pastërtisë dhe të identifikimit të substancave të përdorura në praktikat enologjike janë ato të referuara në kolonën 4, të tabelës 2, të pjesës A, të shtojcës I, të këtij urdhri dhe të aksesueshme publikisht në faqen zyrtare të OIV-së brenda dokumentit "OIV International Enological Codex".

Neni 15
Dispozita kalimtare

Stoqet e produkteve të rrushit për verë, të prodhuara në përputhje me rregullat në fuqi para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri, lejohet të dalin për konsum njerëzor.

Neni 16
Institucionet që ngarkohen

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni përgjegjës për kontrollet, i përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE
ME POROSI
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

SHTOJCA I

PJESA A
PRAKTIKAT ENOLOGJIKE TË AUTORIZUARA

Tabela 1: *Praktikat enologjike të autorizuara, të referuara ne nenin 8 të këtij urdhri*

	1	2	3
	Praktikat enologjike	**Kushtet dhe kufijtë e përdorimit**	**Kategoritë e produkteve të përftuara nga përpunimi i rrushit për verë, sipas nenit 2 të ligjit, ku mund të zbatohet**
1	Ajrimi ose oksigjenimi	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet 2.1.1 dhe 3.5.5 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2	Trajtimet me nxehtësi	Sipas të kushteve të përcaktuara në dokumentet 1.8, 2.2.4, 2.3.6; 2.3.9, 3.4.3 , 3.4.3.1 , 3.5.4 dhe 3.5.10 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
3	Trajtime me ftohje	Sipas të kushteve të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 4. të këtij urdhri dhe në dokumentet 1.14, 1.15, 2.1.12.4, 2.3.6, 3.1.2, 3.1.2.1, 3.3.4 dhe 3.5.11.1 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
4	Centrifugimi dhe filtrimi me ose pa një agjent filtrues inert	Agjentë filtrimi inertë janë ata që përmenden në dokumentet 2.1.11, 2.1.11.1, 3.2.2 dhe 3.2.2.1 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Përdorimi i tyre nuk duhet të lërë mbetje të padëshiruara në produktin e trajtuar.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5	Krijimi i një atmosfere inerte	Vetëm për qëllimin e manovrimit të produktit, duke e mbrojtur nga ajri.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
6	Eliminimi i dyoksidit të squfurit me procese fizike		Rrush i freskët, 20.2, 20.10, 20.11, 20.12, 20.13 dhe 20.14
7	Rrëshira me shkëmbim jonik	Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 2 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Mushti i rrushit i destinuar për prodhim mushti rrushit të përqendruar të korrigjuar
8	Flluskimi *(Bubbling)*	Vetëm kur përdoret argon ose azot.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
9	Pluskimi *(Flotation)*	Vetëm kur përdoret azot ose dyoksid karboni, ose me ajrim. Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 2.1.14 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	20.10, 20.11, 20.12
10	Disqe me parafine të pastër të me përmbajtje alil izotiocianati *(allyl isothiocyanate)*	Vetëm për të krijuar një atmosferë sterile. Përdorimi i alil izotiocianatit u nënshtrohet kushteve dhe kufijve në tabelën 2, të pjesës A të kësaj shtojce për substancat enologjike të autorizuara.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
11	Trajtimi me elektrodializë	Vetëm për të siguruar stabilizimin tartarik të verës. Në varësi të kushteve të përcaktuara në seksionin 4 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
12	Copëza druri lisi (*chips*-a)	Në prodhimin dhe vjetrimin e verës, duke përfshirë fermentimin e rrushit të freskët dhe mushtit të rrushit. Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 6 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
13	Korrigjimi i përmbajtjes alkoolike të verës	Korrigjim kryhet vetëm në verë. Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 7 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
14	Shkëmbyes kationesh për stabilizimin tartarik	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 3.3.3 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Në përputhje me aktin nënligjor të miratuara në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16

15	Trajtim elektro-membranor	Vetëm për acidifikim dhe decidifikim. Sipas kushteve dhe limiteve të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të këtij urdhri. Në përputhje me aktin nënligjor të miratuara në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar dhe me dispozitat e tjera të miratuara në zbatim të tij. Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet 2.1.3.1.3, 2.1.3.2.4, 3.1.1.4, 3.1.2.4 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
16	Shkëmbyes kationesh për acidifikim	Sipas kushteve dhe limiteve të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të këtij urdhri. Në përputhje me aktin nënligjor të miratuara në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar. Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet 2.1.3.1.4 (2012) dhe 3.1.1.5 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
17	Çiftim membranor (*Membrane coupling*)	Vetëm për reduktimin e përmbajtjes së sheqerit në musht. Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 8 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e përmendur në nenin 16 të ligjit.	20.10
18	Membrana kontakti (*Membrane contactors*)	Vetëm për qëllim të menaxhimit të gazit të tretur në verë. Ndalohet shtimi i dyoksidit të karbonit për produktet e përcaktuara në nënpikat 20.4, 20.5, 20.6 dhe 20.8, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit. Në përputhje me aktin nënligjor të miratuara në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar dhe me dispozitat e tjera të miratuara në zbatim të tij. Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 3.5.17 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Trajtimi shënohet në regjistrin e përmendur në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
19	Teknologji membranore e çiftuar me karbon aktiv	Vetëm për qëllim të uljes së teprisë në 4-etilfeol (4-ethylphenol) dhe 4-etilguaiacol (4-ethylguaiacol) në verëra. Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 9 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
20	Pllaka filtruese me përmbajtje zeoliti *y-faujasite*	Vetëm me qëllim të përthithjes së haloanisoleve (*haloanisoles*). Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 3.2.15 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
21	Përqendrim i pjesshëm	Për musht rrushi: sipas kushteve të përcaktuara në germën "b", pika 1, të nenit 2 të këtij urdhri dhe dokumenteve 2.1.12, 2.1.12.1, 2.1.12.2, 2.1.12.3 dhe 2.1.12.4 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Për verë: sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 4 të këtij urdhri dhe dokumenteve 3.5.11 dhe 3.5.11.1 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.15 dhe 20.16
22	Trajtim me proces jo të vazhduar me presion të lartë	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet 1.18 dhe 2.1.26 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	Rrush i freskët, 20.10, 20.11 dhe 20.12.
23	Trajtim me proces të vazhduar me presion të lartë	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 2.2.10 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	20.10, 20.11 dhe 20.12.
24	Trajtim i rrushit të dërrmuar (shtypur) me ultratinguj për të nxitur ekstraktimin e përbërësve të tij.	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 1.17 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	Rrush i freskët.
25	Trajtim i rrushit me fusha elektrike pulsuese	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentin 2.1.27 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së.	Rrush i freskët.
26	Trajtim i mushtit dhe verës, duke përdorur rruaza përthithëse stiren-divinilbenzeni	Sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet 2.2.1 dhe 3.4.22 të Kodit të Praktikave Enologjike të OIV	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.15 dhe 20.16

Tabela 2. *Substancat enologjike të autorizuara të referuara në pikën 1, të nenit 8, të këtij urdhri*

	1	2	3	4	5	6	7	8
	Substancat sipas aktivitetit përkatës	**E number[1] dhe/ose CAS number[2]**	**Kodi i Praktikave Enologjike të OIV-së ([3])**	**Dokumenti i Kodikut Enologjik Ndërkombëtar të OIV-së, sipas nenit 14 të këtij urdhri**	**Aditivë**	**Ndihmues teknologjik/substanca të përdorura për të ndihmuar procesin e përpunimit**	**Kushtet dhe kufijtë e përdorimit ([5])**	**Kategoritë e produkteve të verës (6)**
1	Rregullatorë aciditeti							
1.1	Acid tartrik (L(+)-)	E 334/CAS 87-69-4	Dokumentet 2.1.3.1.1; 3.1.1.1	COEI-1-LTARAC	x		Kushtet dhe kufijtë e përdorimit të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të këtij urdhri. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit. Specifikimet për acidin tartirik (L(+)-) të përcaktuara në pikën 2 të seksionit 1 të kësaj shtojce.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.2	Acid malik (D,L-; L-)	E 296/-	Dokumentet 2.1.3.1.1; 3.1.1.1	COEI-1-ACIMAL	x			20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.3	Acid laktik	E 270/-	Dokumentet 2.1.3.1.1; 3.1.1.1	COEI-1-ACILAC	x			20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.4	Tartrat kaliumi L (+)-	E 336(ii) CAS/921-53-9	Dokumentet 2.1.3.2.2; 3.1.2.2	COEI-1-POTTAR		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.5	Bikarbonat kaliumi	E 501(ii) CAS 298-14-6	Dokumentet 2.1.3.2.2; 3.1.2.2	COEI-1-POTBIC		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.6	Karbonat kalciumi	E 170 CAS 471-34-1	Dokumentet 2.1.3.2.2; 3.1.2.2	COEI-1-CALCAR		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.7	Sulfat kalciumi	E 516/-	Dokumentet 2.1.3.1.1.1		x		Kushtet dhe kufijtë e përcaktuar pikën 2, të Pjesës A të Shtojcës III të këtij urdhri. Niveli maksimal i përdorimit: 2 g/l.	20.3
1.8	Karbonat kaliumi	E 501(i)	Dokumentet 2.1.3.2.5; 3.1.2.2			x	Kushtet dhe kufijtë e përdorimit të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të këtij urdhri. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuara në nenin 16 të ligjit. Për acidin citrik, përmbajtja maksimale në verën e trajtuar dhe të vendosur në treg: 1 g/l.	20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
1.9	Acid citrik	E 330	Dokumentet 3.1.1; 3.1.1.1	COEI-1-CITACI	x			20.1,20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
1.10	Maja për prodhim vere	- / -	Dokumentet 2.1.3.2.3; 2.1.3.2.3.1; 2.3.1 4.1.8	COEI-1-SACCHA, COEI-1-NOSACC		x		20.10, 20.11 dhe 20.12
1.11	Baktere laktike	- / -	Dokumentet 2.1.3.2.3; 2.1.3.2.3.2; 3.1.2, 3.1.2.3	COEI-1-BALACT		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2	**Ruajtës (konservues) dhe antioksidantë**							
2.1	Dyoksid squfuri	E 220/ CAS 7446-09-5	Dokumentet 1.12; 2.1.2; 3.4.4	COEI-1-SOUDIO	x		Kufijtë (d.m.th. sasia maksimale në produktin e vendosur në treg). siç përcaktohet në pjesën B të shtojcës I.	Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2.2	Bisulfit kaliumi	E 228/ CAS 7773-03-7	Dokumentet 1.12; 2.1.2; 3.4.4	COEI-1-POTBIS	x			Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2.3	Metabisulfit kaliumi	E 224/ CAS 16731-55-8	Dokumentet 1.12; 2.1.2; 3.4.4	COEI-1-POTANH	x			Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8,

								20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2.4	Sorbat kaliumi	E 202	Dokumenti 3.4.5	COEI-1-POTSOR	x			20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
2.5	Lizozimë	E 1105	Dokumentet 2.2.6; 3.4.12	COEI-1-LYSOZY	x	x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2.6	Acid L-askorbik	E 300	Dokumentet 1.11; 2.2.7; 3.4.7	COEI-1-ASCACI	x		Përmbajtja maksimale në verën e trajtuar në këtë mënyrë dhe e vendosur në treg: 250 mg/l. Maksimumi 250 mg/l për çdo trajtim.	Rrush i freskët, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
2.7	Dimetildikarbonat (DMDC)	E242/ CAS 4525-33-1	Dokumenti 3.4.13	COEI-1-DICDIM	x		Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
3	**Përthithës (adsorbant)**							
3.1	Qymyr druri për përdorim enologjik		Dokumentet 2.1.9; 3.5.9	COEI-1-CHARBO		x	Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Verëra të bardha, 20.2, 20.10, dhe 20.14
3.2	Fibra bimore përzgjedhëse		Dokumenti 3.4.20	COEI-1-FIBVEG		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
4	**Aktivizues për fermentimin alkoolik dhe malolaktik**							
4.1	Celulozë mikrokristaline	E 460(i)/ CAS 9004-34-6	Dokumentet 2.3.2; 3.4.21	COEI-1-CELMIC		x	Në përputhje me aktet nënligjore që janë miratuar në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar.	Rrush i freskët, 20.2, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.10, 20.11 dhe 20.12
4.2	Diamon fosfat hidrogjeni	E 342/ CAS 7783-28-0	Dokumenti 4.1.7	COEI-1-PHODIA		x	Vetëm për fermentimin alkoolik. Jo më shumë se 1 g/l (shprehur si kripë) (7) ose 0,3 g/l për fermentimin e dytë të verërave të gazuara shkumbëzuese.	Rrush i freskët, 20.2, 20.10, 20.11, 20.12, 20.13, fermentimi i dytë alkoolik i 20.4, 20.5, 20.6 dhe 20.7.
4.3	Sulfat amoni	E 517/ CAS 7783-20-2	Dokumenti 4.1.7	COEI-1AMMSUL		x		
4.4	Bisulfit amoni	- / CAS 10192-30-0		COEI_1-AMMHYD		x	Vetëm për fermentimin alkoolik. Jo më shumë se 0,2 g/l (shprehur si kripë) dhe deri në kufirin e vendosur në pikat 2.1 deri 2.3 të kësaj tabele.	Rrush i freskët, 20.2, 20.10, 20.11, dhe 20.12
4.5	Hidroklorid tiamine	-/ CAS 67-03-8	Dokumentet 2.3.3; 4.1.7	COEI-1-THIAMIN		x	Vetëm për fermentimin alkoolik. Jo më shumë se 0,6 mg/l (shprehur si tiaminë) për çdo trajtim.	Rrush i freskët, 20.2, 20.10, 20.11, 20.12, fermentimi i dytë alkoolik i 20.4, 20.5, 20.6 dhe 20.7
4.6	Maja të autolizuara	-/-	Dokumentet 2.3.2; 3.4.21	COEI-1-AUTLYS		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
4.7	Mure qelizore majash	- /-	Dokumentet 2.3.4; 3.4.21	COEI-1-YEHULL		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9,

								20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
4.8	Maja të inaktivizuara	- /-	Dokumenti 2.3.2; 3.4.21	COEI-1-INAYEA		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
4.9	Maja të inaktivizuara me nivele të garantuara të glutationit	- /-	Dokumenti 2.2.9	COEI-1-LEVGLU		x	Vetëm për fermentimin alkoolik.	Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5	**Agjentë kthjellues**							
5.1	Xhelatinë ushqimore	-/ CAS 9000-70-8	Dokumenti 2.1.6; 3.2.1	COEI-1-GELATI		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.2	Proteinë gruri		Dokumenti 2.1.17; 3.2.7	COEI-1-PROVEG		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.3	Proteinë bizeleje		Dokumenti 2.1.17; 3.2.7	COEI-1-PROVEG		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.4	Proteinë patateje		Dokumenti 2.1.17; 3.2.7	COEI-1-PROVEG		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.5	Xhelatinë peshku *(Isinglass)*		Dokumenti 3.2.1	COEI-1-COLPOI		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
5.6	Kazeinë	-/ CAS 9005-43-0	Dokumenti 2.1.16	COEI-1-CASEIN		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.7	Kazeinate kaliumi	-/ CAS 68131-54-4	Dokumentet 2.1.15; 3.2.1	COEI-1-POTCAS		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.8	Albuminë veze	-/ CAS 9006-59-1	Dokumenti 3.2.1	COEI-1-OEUALB		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
5.9	Bentonit	-/-	Dokumentet 2.1.8; 3.3.5	COEI-1-BENTON		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.10	Dyoksid silikoni (xhel ose tretësirë koloidale)	E 551/-	Dokumentet 2.1.10; 3.2.1; 3.2.4	COEI-1-DIOSIL		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.11	Kaolinë	-/ CAS 1332-58-7	Dokumenti 3.2.1	COEI-1-KAOLIN		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
5.12	Tanine		Dokumentet 2.1.7; 2.1.17; 3.2.6; 3.2.7; 4.1.8; 4.3.2	COEI-1-TANINS		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.15 dhe 20.16

5.13	Kitozan me prejardhje nga *Aspergillus niger*	-/ CAS 9012-76-4	Dokumentet 2.1.22; 3.2.1; 3.2.12	COEI-1-CHITOS		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.14	Kitin-glukan me prejardhje nga *Aspergillus niger*	Chitin: CAS 1398-61-4; Glucan: CAS 9041-22-9.	Dokumentet 2.1.23; 3.2.1; 3.2.13	COEI-1-CHITGL		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.15	Ekstrakt proteinash të majave	- /-	Dokumentet 2.1.24; 3.2.14; 3.2.1	COEI-1-EPLEV		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
5.16	Polivinilpolipirolidon (Polyvinylpolypyrrolidone)	E 1202/ CAS 25249-54-1	Dokumentet 3.4.9	COEI-1-PVPP		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.15 dhe 20.16
5.17	Alginat kalciumi	E 404/ CAS 9005-35-0	Dokumenti 4.1.8	COEI-1-ALGIAC		x	Vetëm në prodhimin e të gjitha kategorive të verërave të gazuara dhe pjesërisht të gazuara të përftuara nga fermentimi në shishe dhe me ndarje të llumit përmes "disgorging".	20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8 dhe 20.9
5.18	Alginat kaliumi	E 402/ CAS 9005-36-1	Dokumenti 4.1.8	COEI-1-POTALG		x		20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8 dhe 20.9
6	**Agjentë stabilizues**							
6.1	Hidrogjen-tartrat kaliumi	E336(i)/ CAS 868-14-4	Dokumenti 3.3.4	COEI-1-POTBIT		x	Vetëm për të ndihmuar fundërrimin e kripërave tartrike.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.2	Tartrat kalciumi	-/-	Dokumenti 3.3.12	COEI-1-CALTAR		x		Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.3	Acid citrik	E 330	Dokumenti 3.3.8; 3.3.1	COEI-1-CITACI	x		Maksimumi i përmbajtjes në verëra të trajtuara dhe të vendosura në treg: 1 g/l	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.4	Tanine	-/-	Dokumentet 2.1.7, 3.2.6, 3.3.1	COEI-1-TANINS				Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
6.5	Ferrocianur kaliumi	E 536/-	Dokumenti 3.3.1;3.3.10	COEI-1-POTFER		x	Sipas kushteve të vendosura në seksionin 3 të kësaj shtojce. Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.6	Fitat kalciumi	-/ CAS 3615-82-5	Dokumenti 3.3.1	COEI-1-CALPHY		x	Vetëm për verërat e kuqe, jo më shumë se 8 g/hl. Sipas kushteve të përcaktuara në seksionin 3 të kësaj shtojce.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.7	Acid metatartrik	E 353/			x			Musht pjesërisht i fermentuar për

		-	Dokumenti 3.3.7	COEI-1-METACI				konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.8	Gomë arabike	E 414/ CAS 9000-01-5	Dokumenti 3.3.6	COEI-1-GOMARA	x		Sasia që është e mjaftueshme *(Quantum satis)*	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.9	Acid tartrik D, L- ose kriperat neutrale të tij të kaliumit.	-/ CAS 133-37-9	Dokumenti 2.1.21; 3.4.15	COEI-1-DLTART		x	Vetëm për fundërrimin e kalciumit të tepërt. Sipas kushteve të vendosura në seksionin 3 të kësaj shtojce.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.10	Manoproteina majash	- / -	Dokumenti 3.3.13	COEI-1-MANPRO	x			Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.11	Karboksimetilcelulozë	E466/-	Dokumenti 3.3.14	COEI-1-CMC	x		Vetëm për të siguruar stabilizimin tartrik.	Verëra të bardha, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9
6.12	Kopolimerë të polivinilimidazol-polivinilpirolidonit (PVI/PVP)	-/CAS 87865-40-5	Dokumenti 2.1.20; 3.4.14	COEI-1-PVIPVP		x	Trajtimi shënohet në regjistrin e parashikuar në nenin 16 të ligjit.	20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
6.13	Poliaspartat kaliumi	E 456/ CAS 64723-18-8	Dokumenti 3.3.15	COEI-1-POTPOL	x		Vetëm për të kontribuar në stabilizimin tartrik.	20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
6.14	Acid fumarik	E 297/ CAS 110-17-8	Dokumentet 3.4.2, 3.4.23		x			20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
7	**Enzima**							
7.1	Ureazë	EC 3.5.1.5	Dokumenti 3.4.11	COEI-1-UREASE COEI-1-PRENZY		x	Vetëm për të reduktuar nivelin e uresë në verë Sipas kushteve të vendosura në seksionin 5 të kësaj shtojce.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
7.2	Pektin-liazë	EC 4.2.2.10	Dokumentet 1.13, 2.1.4; 2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-ACTPLY COEI-1-PRENZY		x	Vetëm për qëllime enologjike në macerim, kthjellim, stabilizim, filtrim dhe për të zbuluar prekursorët aromatik të rrushit.	Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.3	Pektin-metilesterazë	EC 3.1.1.11	Dokumentet 1.13, 2.1.4; 2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-ACTPME COEI-1-PRENZY		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.4	Poligalakturonazë	EC 3.2.1.15	Dokumentet 1.13, 2.1.4; 2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-ACTPGA COEI-1-PRENZY		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.5	Hemicelulazë	EC 3.2.1.78	Dokumentet 1.13, 2.1.4; 2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-ACTGHE COEI-1-PRENZY		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.6	Celulazë	EC 3.2.1.4	Dokumentet 1.13, 2.1.4;	COEI-1-ACTCEL		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6,

			2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-PRENZY				20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.7	Betaglukanazë	EC 3.2.1.58	Dokumenti 3.2.10	COEI-1-BGLUCA COEI-1-PRENZY		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
7.8	Glykosidazë	EC 3.2.1.20	Dokumentet 2.1.19; 3.2.9	COEI-1-PRENZY		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.9	Arabinanazë	EC 3.2.1.99	Dokumentet 1.13, 2.1.4; 2.1.18; 3.2.8; 3.2.11	COEI-1-ACTARA COEI-1-PRENZY		x		Rrush i freskët, 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.10	Beta-glukanazë (β1-3, β1-6)	EC 3.2.1.6	Dokumenti 3.5.7	COEI-1-ACTGLU COEI-1-PRENZY		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
7.11	Glukosidazë	EC 3.2.1.21	Dokumentet 2.1.19; 3.2.9	COEI-1-GLYCOS COEI-1-PRENZY		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
7.12	*Aspergillopepsin I*	EC 3.4.23.18	Dokumentet 2.2.12; 3.3.16	COEI-1-PROTEA COEI-1-PRENZY		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
8	**Gazra dhe gazra paketimi**							
8.1	Argon	E 938/ CAS 7440-37-1	Dokumentet 2.2.5; 3.2.3	COEI-1-ARGON	x	x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
8.2	Azot	E 941/ CAS 7727-37-9	Dokumentet 2.1.14; 2.2.5; 3.2.3	COEI-1-AZOTE	x	x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
8.3	Dyoksid karboni	E 290/ CAS 124-38-9	Dokumentet 1.7; 2.1.14; 2.2.3; 2.2.5; 2.3.9; 4.1.10	COEI-1-DIOCAR	x	x	Në rastin e verërave të qeta, përmbajtja maksimale e dyoksidit të karbonit në verën e trajtuar dhe të vendosur në treg është 3 g/l, ndërsa mbipresioni i shkaktuar nga dyoksidi i karbonit duhet të jetë më pak se 1 bar në një temperaturë prej 20°C.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
8.4	Oksigjen i gaztë	E 948/ CAS 17778-80-2	Dokumentet 2.1.1; 3.5.5	COEI-1-OXYGEN		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
9	**Agjentë fermentues**							
9.1	Maja për prodhim vere	- /-	Dokumentet 2.1.3.2.3.1; 2.3.1; 4.1.8	COEI-1-SACCHA COEI-1-NOSACC		x		Rrush i freskët, 20.2, 20.10, 20.11, 20.12, 20.13, fermentimi alkoolik dytësor i 20.4, 20.5, 20.6 dhe 20.7
9.2	Baktere laktike	- / -	Dokumentet 2.1.3.2.3.2, 3.1.2; 3.1.2.3	COEI-1-BALACT		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.15 dhe 20.16
10	**Korrigjimi i defekteve**							
10.1	Sulfat bakri, pentahidrat	-/ CAS 7758-99-8	Dokumenti 3.5.8	COEI-1-CUISUL		x	Jo më shumë se 1 g/hl, me kusht që përmbajtja e bakrit në produktin e trajtuar në këtë mënyrë të mos kalojë 1 mg/l, me përjashtim të verërave	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16

10.2	Citrat bakri	-/ CAS 866-82-0	Dokumenti 3.5.14	COEI-1-CUICIT		x	likeroze të përgatitura nga mushti i rrushit i freskët i pafermentuar ose pak i fermentuar, për të cilin përmbajtja e bakrit nuk mund të kalojë 2 mg/l.	Musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, 20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
10.3	Kitozan me prejardhje nga Aspergillus niger	-/ CAS 9012-76-4	Dokumenti 3.4.16	COEI-1-CHITOS		x		20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
10.4	Kitin-glukan me prejardhje nga Aspergillus niger	Kitinë: CAS 1398-61-4; Glukan: CAS 9041-22-9.	Dokumenti 3.4.17	COEI-1-CHITGL		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
10.5	Maja e inaktivizuar	-/-		COEI-1-INAYEA		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16
11	**Praktika të tjera**							
11.1	Llum i freskët	-/-				x	Vetëm në verëra të thata. Llumi i freskët është i paholluar dhe përmban maja që rezultojnë nga vinifikimi i fundit i verës së thatë. Sasi që nuk kalojnë 5% të vëllimit të produktit të trajtuar.	20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.15 dhe 20.16
11.2	Karamel	E 150 a-d/-	Dokumenti 4.3	COEI-1-CARAMEL	x		Për të përforcuar ngjyrën siç përcaktohet në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të pikës 12 të nenit 41 të ligjit për ushqimin.	20.3
11.3	Alil-isotiociant (allyl isothiocyanate)	-/57-06-7				x	Vetëm për të ngopur disqet me parafinë të pastër. Shih tabelën 1 të pjesës A të kësaj shtojce. Në verë nuk duhet të ketë asnjë gjurmë të alilit izotiocianatit.	Vetëm për musht pjesërisht i fermentuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, dhe verë.
11.4	Maja e inaktivizuar	-/-		COEI-1-INAYEA		x		20.1, 20.3, 20.4, 20. 5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10, 20.11, 20.12, 20.15 dhe 20.16

(1) Numrat evropianë janë kode për substancat e përdorura si aditivë ushqimorë ose ndihmës për përpunim, në përputhje me aktin nënligjor të miratuar në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar.

(2) Numri i regjistrit CAS është një numër unik identifikimi i caktuar nga *Chemical Abstracts Service (CAS)* në SHBA, për çdo substancë kimike të përshkruar në literaturën publike shkencore.

(3) Praktikë enologjike e autorizuar në përputhje me referencën e dokumentit në Kodin e Praktikave Enologjike të OIV-së dhe në varësi të kushteve dhe kufijve të përdorimit të përcaktuara në këtë tabelë.

(4) Substanca të përdorura si ndihmës teknologjik, në përputhje me aktin nënligjor të miratuar në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar.

(5) Substancat enologjike të autorizuara duhet të përdoren në përputhje me dispozitat që përmbahen në dokumentet e Kodit të Praktikave Enologjike të OIV-së të përmendura në kolonën 3 të kësaj tabele, përveç rasteve kur zbatohen kushte dhe kufizime të mëtejshme të përdorimit siç përcaktohet në këtë kolonë.

(6) Zbatohet për kategoritë e produkteve të verës të përcaktuara në pikën 20, nenin 2, të ligjit dhe të përfshira në këtë kolonë.

(7) Kripërat e amonit referuar në rreshtat 4.2, 4.3 dhe 4.4 mund të përdoren të kombinuara, deri të kufirin maksimal të 1g/l ose 0,3 g/l për fermentimin e dytë të verës së gazuar. Kripa e amonit e referuar në rreshtin 4.4 nuk mund të kalojë kufirin e referuar në linjën 4.4.

Seksioni 1
Acid tartrik (L(+)-) dhe produkte të derivuara

1. Acidi tartrik, përdorimi i të cilit parashikohet në pikën 1.1. të tabelës 2, të kësaj shtojce, i quajtur edhe acidi tartrik (L(+)), duhet të jetë me origjinë bujqësore dhe i nxjerrë specifikisht nga produkte të verës.

2. Produktet e derivuara të acidit tartrik (L(+)-), të listuara më poshtë, përdorimi i të cilave parashikohet në pikat në vazhdim pas pikës 1.1. të tabelës 2, të kësaj shtojce, duhet të jenë me origjinë bujqësore:

- Tartrat kaliumi (1.4);
- Hidrogjen-tartrat kaliumi (6.1);
- Acid metatartrik (6.7).

Seksioni 2
Rrëshira me shkëmbim jonik

Rrëshirat me shkëmbim jonik të cilat përdoren në përputhje me pikën 7, të tabelës 1, të kësaj shtojce, janë kopolimerë të stirenit dhe divinilbenzenit që përmbajnë acid sulfonik ose grupe amoni. Ato respektojnë kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të pikës 12, të neni 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore, të miratuara në zbatim të tij. Përveç kësaj, kur testohen me metodën e analizës të përcaktuar në paragrafin e tretë të këtij seksioni, ato nuk duhet të humbasin më shumë se 1 mg/l lëndë organike në asnjë nga tretësit e listuar. Ato duhet të rigjenerohen me substanca të lejuara për përdorim në përgatitjen e produkteve ushqimore.

Këto rrëshira përdoren vetëm nën mbikëqyrjen e një enologu ose tekniku.

Metoda e analizës për përcaktimin e humbjes së lëndës organike nga rrëshirat e shkëmbimit të joneve:

1. QËLLIMI DHE FUSHA E APLIKIMIT

Metoda përcakton humbjen e lëndës organike nga rrëshirat me shkëmbim jonik.

2. PËRKUFIZIMI

Humbja e lëndës organike nga rrëshirat me shkëmbim jonik. Humbja e lëndës organike përcaktohet me metodën e specifikuar këtu.

3. PARIMI

Tretësit ekstraktues kalohen përmes rrëshirave të përgatitura dhe pesha e lëndës organike të nxjerrë përcaktohet në mënyrë gravimetrike.

4. REAGJENTËT

Të gjithë reagjentët duhet të jenë të gradës analitike. Tretësit ekstraktues:

4.1. Ujë i distiluar ose ujë i dejonizuar me pastërti të barasvlershme.

4.2. Etanol, 15% v/v. Përgatitet duke përzier 15 pjesë etanol absolut me 85 pjesë ujë (pika 4.1).

4.3. Acid acetik, 5% m/m. Përgatitet duke përzier 5 pjesë të acidit acetik anhidër (pa ujë) me 95 pjesë ujë (pika 4.1).

5. PAJISJET

5.1. Kolona kromatografike me shkëmbim jonik.

5.2. Cilindra matës me kapacitet 2 l.

5.3. Enë avullimi të afta për t'i rezistuar një furre mufël në 850°C.

5.4. Furrë tharëse, e kontrollueshme me termostat në 105 ± 2°C.

5.5. Furrë mufël, e kontrollueshme me termostat në 850 ± 25°C.

5.6. Peshore analitike me saktësi deri në 0,1 mg.

5.7. Evaporator, pllakë ngrohëse ose evaporator me rreze infra të kuqe.

6. PROCEDURA

6.1. Shtoni në secilën prej tri kolonave të veçanta kromatografike me shkëmbim jonik (pika 5.1) 50 ml të rrëshirës me shkëmbin jonik për t'u testuar, larë dhe trajtuar në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për përgatitjen e rrëshirave për përdorim me ushqime.

6.2. Për rrëshirat anionike, kalohen veçmas tre tretësit ekstraktues (pikat 4.1, 4.2 dhe 4.3) nëpër kolonat e përgatitura (pika 6.1) me një shpejtësi rrjedhjeje prej 350 deri në 450 ml/h. Hidhet litri i parë i eluentit në çdo rast dhe dy litrat e ardhshëm mblidhen në cilindra matëse (pika 5.2). Për rrëshirat kationike, kalohen vetëm tretësit e përmendur në pikat 4.1 dhe 4.2 nëpër kolonat e përgatitura për këtë qëllim.

6.3. Avullohen të tre eluentët mbi një pllakë ngrohëse ose me një evaporator me rreze infra të kuqe (pika 5.7) në enë avulluese të veçanta (pika 5.3), të cilat janë pastruar dhe peshuar më parë (m0). Vendosen enët në furrë (pika 5.4) dhe thahen deri në peshë konstante (m1).

6.4. Pas regjistrimit të peshës konstante (pika 6.3), vendosni enën e avullimit në furrën mufël (pika 5.5) deri sa hiri të ketë peshë konstante (m2).

6.5. Llogaritet lënda organike (pika 7.1). Nëse rezultati është më i madh se 1 mg/l, kryhet një provë

boshe me reagjentët dhe rillogaritet pesha e lëndës organike të nxjerrë.

Prova boshe kryhet duke përsëritur veprimet e përmendura në pikat 6.3 dhe 6.4, por duke përdorur dy litra tretës ekstraktues, për të dhënë respektivisht peshat m3 dhe m4 në pikat 6.3 dhe 6.4.

7. SHPREHJA E REZULTATEVE

7.1. Formula dhe llogaritja e rezultateve

Lënda organike e nxjerrë nga rrëshirat me shkëmbim jonik, në mg/l, jepet nga:

$$500\ (m1 - m2)$$

ku m1 dhe m2 janë të shprehura në gramë.

Pesha e korrigjuar (mg/l) e lëndës organike të ekstraktuar nga rrëshirat me shkëmbim jonik, jepet nga

$$500\ (m1 - m2 - m3 + m4)$$

ku m1, m2, m3 dhe m4 janë të shprehura në gramë.

7.2. Dallimi në rezultatet ndërmjet dy përcaktimeve paralele të kryera në të njëjtën kampion nuk duhet të kalojë 0,2 mg/l.

Seksioni 3
Ferrocianur kaliumi
Fitat kalciumi

Acidi tartrik DL

Ferrocianuri i kaliumit ose fitati i kalciumit, përdorimi i të cilit parashikohet në pikat 6.5 dhe 6.6, të tabelës 2 të kësaj shtojce, OSE acidi tartrik DL, përdorimi i të cilit parashikohet në pikën 6.9, të tabelës 2 të kësaj shtojce, përdoret vetëm nën mbikëqyrjen e një enologu ose tekniku të miratuar zyrtarisht.

Pas trajtimit me ferrocianur kaliumi ose fitat kalciumi, vera duhet të përmbajë gjurmë hekuri.

Seksioni 4
Kërkesat për trajtimin me elektrodializë

Qëllimi është të sigurohet stabiliteti tartrik i verës në lidhje me hidrogjen tartratin e kaliumit dhe tartratin e kalciumit (dhe kripërat e tjera të kalciumit) me nxjerrjen e joneve në gjendje mbingopjeje në verë, nën veprimin e një fushe elektrike dhe duke përdorur membrana që janë të përshkueshme nga anionet ose nga kationet.

1. KËRKESAT E MEMBRANËS

1.1. Membranat duhet të vendosen në mënyrë alternative në një sistem të tipit "filtër-presë" ose në ndonjë sistem tjetër të përshtatshëm që ndan produktin e trajtuar (vera) nga pjesa e përqendruar (ujërat e ndotura).

1.2. Membranat e përshkueshme nga kationet duhet të projektohen për të ekstraktuar vetëm katione, në veçanti K+, Ca++.

1.3. Membranat e përshkueshme nga anionet duhet të projektohen për të ekstraktuar vetëm anione, në veçanti anionet e tartratit.

1.4. Membranat nuk duhet të modifikojnë së tepërmi përbërjen fiziko-kimike dhe karakteristikat shqisore të verës. Ato duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të jenë të prodhuara sipas praktikave të mira të prodhimit, nga substanca të autorizuara për prodhimin e materialeve plastike të destinuara për të ardhur në kontakt me produktet ushqimore, sipas akteve nënligjore të miratuara në zbatim të pikës 12, të nenit 41, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar;

b) përdoruesi i pajisjes së elektrodializës duhet të tregojë se membranat e përdorura plotësojnë kërkesat e mësipërme dhe se çdo zëvendësim është kryer nga personel i specializuar;

c) nuk duhet të lëshojnë asnjë substancë në sasi që rrezikon shëndetin e njeriut ose ndikon në shijen ose aromën e produkteve ushqimore;

ç) përdorimi i tyre nuk duhet të shkaktojë ndërveprime ndërmjet përbërësve të tyre dhe verës që mund të rezultojë në formimin e përbërjeve të reja në produktin e trajtuar, të cilat mund të jenë toksike.

Stabiliteti i membranave të reja të elektrodializës duhet të përcaktohet duke përdorur një simulant që riprodhon përbërjen fiziko-kimike të verës, për hetim te migrimit të mundshëm të disa substancave prej tyre.

Metoda eksperimentale e rekomanduar është si vijon:

Simulanti është një solucion ujë-alkool në pH dhe konduktivitetin e verës. Përbërja e tij është si më poshtë:

i. etanol absolut: 11 l;

ii. hidrogjen tartrat kaliumi: 380 g;

iii. klorur kaliumi: 60 g;

iv. acid sulfurik i përqendruar: 5 ml;

v. ujë i distiluar: deri sa të arrijë 100 litra.

Kjo tretësirë përdoret për teste migrimi me qark të mbyllur në një grup elektrodialize nën tension (1 volt/qelizë), mbi bazë membranash anionike dhe

kationike 50 l/m2, deri në demineralizimin e 50% të tretësirës. Qarku i efluentit iniciohet nga një tretësirë 5 g/l e klorurit të kaliumit. Substancat migruese testohen si në simulant ashtu edhe në efluent.

Përcaktohen molekulat organike që hyjnë në përbërjen e membranës, të cilat mund të migrojnë në tretësirën e trajtuar. Për secilin prej këtyre përbërësve kryhet një përcaktim specifik nga një laborator i miratuar. Përmbajtja në lëngun simulant e të gjitha përbërjeve të përcaktuara duhet të jetë më e vogël se 50 μg/l.

Në këto membrana zbatohen rregullat e përgjithshme për kontrollin e materialeve në kontakt me produktet ushqimore.

2. KËRKESAT PËR PËRDORIMIN E MEMBRANËS

Çifti membranor është formuluar në mënyrë që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ulja e pH të verës nuk duhet të jetë më shumë se 0,3 njësi pH;

b) ulja e aciditetit avullues (volatile) duhet të jetë më pak se 0,12 g/l (2 miliekuivalentë të shprehur si acid acetik);

c) trajtimi nuk duhet të ndikojë në përbërësit jojonikë të verës, veçanërisht te polifenolet dhe polisakaridet;

ç) duhet të reduktohet difuzioni i molekulave të vogla, si etanoli dhe nuk duhet të shkaktojë ulje të fortësisë alkoolike më shumë se 0,1% vol.;

d) membranat duhet të konservohen dhe pastrohen me metoda të miratuara përmes substancave të autorizuara për përdorim në përgatitjen e produkteve ushqimore;

dh) membranat janë të shenjuara në mënyrë që të mund të kontrollohet alternimi i tyre;

e) pajisja duhet të vihet në punë duke përdorur një mekanizëm komandimi dhe kontrolli që do të marrë parasysh paqëndrueshmërinë specifike të secilës verë, në mënyrë që të largojë vetëm mbingopjen në hidrogjen tartrat kaliumi dhe kripëra kalciumi;

ë) trajtimi kryhet nën përgjegjësinë e një enologu ose tekniku të kualifikuar.

Trajtimi duhet të regjistrohet në regjistrin e hyrjeve dhe të daljeve të përcaktuar në nenin 16 të ligjit.

Seksioni 5
Kërkesat për ureazën

1. Kodet ndërkombëtare për ureazën: EC 3-5-1-5, CAS No: 9002-13-5.

2. Aktiviteti: Aktiviteti i ureazës (aktive në pH acid) është zbërthimi i uresë në amoniak dhe dyoksid karboni. Ky aktivitet nuk është më pak se 5 njësi/mg, një njësi përcaktohet si sasia që prodhon një μmol amoniak në minutë në 37°C nga 5 g/l ure në pH 4.

3. Origjina: *Lactobacillus fermentum*.

4. Fusha e aplikimit: zbërthimi i uresë së pranishme në verë të synuar për vjetrim të zgjatur, ku përqendrimi fillestar i uresë është më i lartë se 1 mg/l.

5. Doza maksimale: 75 mg preparat enzimë për litër verë të trajtuar, jo më shumë se 375 njësi ureazë për litër verë. Pas trajtimit, i gjithë aktiviteti i mbetur i enzimës duhet të eliminohet duke filtruar verën (madhësia e poreve < 1 μm).

6. Specifikimet e pastërtisë kimike dhe mikrobiologjike:

Humbje nga tharja	Më pak se 10%
Metale të rënda	Më pak se 30 ppm
Pb	Më pak se 10 ppm
As	Më pak se 2 ppm
Koliforme totale	Jo të pranishëm
Salmonella spp	Jo të pranishëm në 25 g mostër
Numëri total i baktereve aerobe	Më pak se 5×10^4 qeliza/g

Seksioni 6
Kërkesat për copëzat e drurit të lisit

QËLLIMI, ORIGJINA DHE FUSHA E APLIKIMIT

Copëzat e drurit të lisit përdoren në prodhimin e verës dhe vjetrimin e saj, përfshirë fermentimin e rrushit të freskët dhe mushtit të rrushit, për të kaluar disa karakteristika të drurit të lisit në verë.

Copëzat e drurit të lisit duhet të vijnë ekskluzivisht nga gjinia *Quercus*.

Ato mund të lihen në gjendjen e tyre natyrale ose të nxehen në një temperaturë të ulët, mesatare ose të lartë, por nuk duhet të kenë pësuar djegie, duke përfshirë djegien e sipërfaqes, as të jenë karbonizuar ose të shkrifëta në prekje. Ato nuk duhet të kenë pësuar asnjë proces kimik, enzimatik apo fizik përveç nxehjes. Asnjë produkt nuk mund të shtohet me qëllim të rritjes së aromës së tyre natyrale ose sasisë së përbërjeve fenolike të ekstraktueshme.

ETIKETIMI

Në etiketë duhet të përmendet origjina e specieve botanike të lisit dhe intensiteti i nxehjes (nëse janë trajtuar me nxehtësi), kushtet e ruajtjes dhe masat paraprake të sigurisë.

PËRMASAT

Përmasat e grimcave të drurit duhet të jenë të tilla që të paktën 95% e peshës së tyre të mbahet nga një filtër rrjete me dimensione të hapjeve 2 mm.

PASTËRTIA

Copëzat e drurit të lisit nuk duhet të çlirojnë asnjë lëndë në përqendrime që mund të jetë e dëmshme për shëndetin.

Trajtimi duhet të regjistrohet në regjistrin e hyrjeve dhe të daljeve të përcaktuar në nenin 16 të ligjit.

Seksioni 7
Kërkesat për trajtimin e korrigjimit të përmbajtjes alkoolike të verërave

Qëllimi i trajtimit për korrigjimin e përmbajtjes së alkoolit ("trajtimi") është të reduktojë nivelet e tepërta të etanolit në verë, me qëllim përmirësimin e ekuilibrit të shijes.

Kërkesat:

1. Objektivat mund të arrihen me teknika ndarjeje, të zbatuara veçmas ose në kombinim.

2. Verërat e trajtuara nuk duhet të kenë defekte organoleptike dhe duhet të jenë të përshtatshme për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit.

3. Eliminimi i alkoolit nga vera nuk mund të kryhet, nëse një nga proceset e pasurimit të përcaktuara në nenet 3, 4, 5 ose 6 të këtij urdhri, është zbatuar në një nga produktet e verës të përdorura për përgatitjen e verës në fjalë.

4. Përmbajtja e alkoolit mund të reduktohet me një maksimum prej 20% dhe fortësia alkoolike totale në vëllim e produktit përfundimtar duhet të jetë në përputhje me atë të përcaktuar në pikën 20.1, të nenit 2 të ligjit.

5. Trajtimi nën përgjegjësinë e një enologu ose tekniku të kualifikuar.

Seksioni 8
Kërkesat për trajtimin e reduktimit të përmbajtjes së sheqerit të mushtit përmes çiftëzimit membranor

Qëllimi i trajtimit për reduktimin e përmbajtjes së sheqerit ("trajtimi") është largimi i sheqerit nga një musht, me anë të çiftimit membranor që bashkon mikrofiltrimin ose ultrafiltrimin me nanofiltrimin ose osmozën e kundërt.

Kërkesat:

1. Trajtimi shkakton një ulje të vëllimit në funksion të sasisë së përmbajtjes së sheqerit të hequr nga mushti fillestar.

2. Proceset duhet të ruajnë përmbajtjen e përbërësve të mushtit, përveç sheqernave.

3. Reduktimi i përmbajtjes së sheqerit në musht përjashton korrigjimin e përmbajtjes së alkoolit në verërat që përftohen prej tij.

4. Trajtimi nuk duhet të përdoret në kombinim me ndonjë nga operacionet e pasurimit të parashikuara në nenin 4, të këtij urdhri.

5. Trajtimi kryhet në një vëllim mushti, të përcaktuar në funksion të objektivit të synuar të reduktimit të përmbajtjes së sheqerit.

6. Objektivi i fazës së parë është të bëjë mushtin të përshtatshëm për fazën e dytë të përqendrimit dhe të ruajë makromolekulat me madhësi më të madhe se pragu i prerjes së membranës. Kjo fazë mund të kryhet me ultrafiltrim.

7. Permeati (lëngu që kalon membranën) i marrë gjatë fazës së parë të trajtimit më pas përqendrohet me nanofiltrim ose osmozë të kundërt.

Uji fillestar dhe acidet organike që nuk mbahen, në veçanti nga nanofiltrimi, mund të rifuten në mushtin e trajtuar.

8. Trajtimi kryhet nën përgjegjësinë e një enologu ose teknik të kualifikuar.

9. Membranat e përdorura duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Kodit Ndërkombëtar Enologjik të publikuar nga OIV-ja.

Seksioni 9
Kërkesat për trajtimin e verërave duke përdorur teknologjinë membranore të çiftuar me karbon të aktivizuar për të reduktuar tepricat e 4-etilfenolit dhe 4-etilguaiakolit

Qëllimi i trajtimit është reduktimi i përmbajtjes së 4-etilfenolit dhe 4-etilguaiakolit me origjinë mikrobiale, të cilat shkaktojnë defekte organoleptike dhe maskojnë aromat e verës.

Kërkesat:

1. Trajtimi kryhet nën përgjegjësinë e një enologu ose tekniku të kualifikuar.

2. Duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Kodit Ndërkombëtar Enologjik të publikuar nga OIV-ja.

PJESA B
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E DYOKSIDIT TË SQUFURIT NË VERËRA

A. PËRMBAJTJA E DYOKSIDIT TË SQUFURIT NË VERËRA

1. Përmbajtja totale e dyoksidit të squfurit të verërave, përveç verërave shkumbëzuese ose të gazuara dhe verërave të fortifikuara likeroze, në daljen e tyre në treg për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit, nuk duhet të kalojë:

a) 150 miligramë për litër për verërat e kuqe;

b) 200 miligramë për litër për verërat e bardha dhe rozë/trëndafil.

2. Pavarësisht përcaktimeve në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të kësaj pjese, përmbajtja maksimale e dyoksidit të squfurit rritet për verërat me një përmbajtje sheqeri, të shprehur si shuma e glukozës dhe fruktozës, jo më pak se pesë gramë për litër, si vijon:

a) 200 miligramë për litër për verërat e kuqe;

b) 250 miligramë për litër për verërat e bardha dhe rozë/trëndafil;

c) 300 miligramë për litër për verërat me një fortësi alkoolike totale, sipas vëllimit më shumë se 15% vol. dhe me një përmbajtje sheqeri më shumë se 45 g/l;

ç) kufij më të lartë se ato të përcaktuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike, për verëra specifike me emërtim origjine të mbrojtur ose tregues gjeografikë të mbrojtur.

3. Në vitet kur kushtet klimatike e bëjnë jashtëzakonisht të nevojshme, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, ministri mund të autorizojë një rritje deri në 50 miligramë për litër të niveleve maksimale totale të dyoksidit të squfurit, prej më pak se 300 miligramë për litër, për verëra të prodhuara në zona të caktuara të kultivimit të vreshtave.

B. PËRMBAJTJA E DYOKSIDIT TË SQUFURIT NË VERËRA TË FORTIFIKUARA LIKEROZE

Përmbajtja totale e dyoksidit të squfurit në verërat e fortifikuara likeroze, në daljen e tyre në treg për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit, nuk duhet të kalojë:

a) 150 mg/l kur përmbajtja e sheqerit është më pak se 5 g/l;

b) 200 mg/l kur përmbajtja e sheqerit nuk është më pak se 5 g/l.

C. PËRMBAJTJA E DYOKSIDIT TË SQUFURIT NË VERËRAT VERËRA SHKUMBËZUESE OSE TË GAZUARA

1. Përmbajtja totale e dyoksidit të squfurit në verërat shkubëzuese ose të gazuara, kur ato nxirren në treg për konsum të drejtpërdrejtë nga njerëzit, nuk duhet të kalojë:

a) 185 mg/l për të gjitha kategoritë e verërave shkumbëzuese cilësore;

b) 235 mg/l për verërat e tjera shkubëzuese ose të gazuara.

2. Kur kushtet klimatike e bëjnë të nevojshme, në zona të caktuara të kultivimit të vreshtave, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, ministri mund të autorizojë një rritje deri në 40 mg/l të përmbajtjes maksimale totale të dyoksidit të squfurit për verërat e gazuara të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1, të kësaj pjese, me kusht që verërat e mbuluara nga ky autorizim të mos eksportohen jashtë vendit.

PJESA C
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E ACIDIT AVULLUES NË VERËRA

1. Përmbajtja e acidit avullues nuk duhet të kalojë:

a) 18 miliekuivalentë për litër për mushtin e rrushit pjesërisht të fermentuar;

b) 18 miliekuivalentë për litër për verërat e bardha dhe rozë/trëndafil; ose

c) 20 miliekuivalentë për litër për verërat e kuqe.

2. Nivelet e përcaktuara në pikën 1, të kësaj pjese, zbatohen:

a) për produktet nga rrushi i vjelë brenda vendit, në fazën e prodhimit dhe në të gjitha fazat e tregtimit;

b) për verërat me origjinë nga vende të tjera, në të gjitha fazat pas hyrjes së tyre në Shqipëri.

3. Pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, ministri mund të miratojë përjashtime nga kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të kësaj pjese:

a) për disa verëra me emërtim origjine të mbrojtur ose tregues gjeografikë të mbrojtur:

i. kur ato janë vjetruar për një periudhë të paktën dyvjeçare; ose

ii. kur janë prodhuar sipas metodave të veçanta;

b) për verërat me një fortësi totale alkoolike, sipas vëllimit prej të paktën 13% vol.

PJESA D
KUFIJTË DHE KUSHTET PËR ËMBËLSIMIN E VERËRAVE

1. Ëmbëlsimi i verës autorizohet vetëm nëse kryhet duke përdorur një ose më shumë nga produktet e mëposhtme:

a) musht rrushi;

b) musht rrushi i përqendruar;

c) musht rrushi i përqendruar i korrigjuar.

Fortësia alkoolike totale, sipas vëllimit e verës në fjalë, nuk mund të rritet me më shumë se 4% vol.

2. Ëmbëlsimi i një vere me emërtim origjine të mbrojtur mund të bëhet vetëm nëse kryhet:

a) në përputhje me kushtet dhe kufijtë e përcaktuar në këtë shtojcë;

b) brenda rajonit ku është prodhuar vera ose brenda një zone ngjitur me të.

Mushti i rrushit dhe mushti i përqendruar i rrushit të referuar në pikën 1 të kësaj pjese duhet të kenë origjinën nga i njëjti rajon si vera që do të ëmbëlsohet.

3. Ëmbëlsimi i verërave lejohet vetëm në fazat e prodhimit dhe të tregtimit me shumicë.

SHTOJCA II
PRAKTIKAT ENOLOGJIKE TË AUTORIZUARA DHE KUFIZIMET E APLIKUARA TEK VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE, VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE CILËSORE DHE VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE CILËSORE AROMATIKE

A. VERË E GAZUAR SHKUMBËZUESE

1. Për qëllimet e kësaj pike dhe pjesëve B dhe C të kësaj shtojce:

a) *"Tirage liqueur"* është produkti i shtuar në *cuvée* për të nxitur fermentimin dytësor për formimin e gazit.

b) *"Expedition liqueur"* është produkti që u shtohet verërave të gazuara shkumbëzuese për t'u dhënë atyre cilësi shijesore të veçanta.

2. *Expedition liqueur* mund të përmbajë vetëm:

a) Sakarozë;

b) Musht rrushi;

c) Musht rrushi në fermentim;

ç) Musht rrushi i përqendruar;

d) Musht rrushit i përqendruar i korrigjuar;

dh) Verë; ose

e) Një përzierje të këtyre, me mundësinë e shtimit të distilateve të verës.

3. Pa rënë ndesh me pasurimin e autorizuar në përputhje me nenet 3, 4 dhe 6 të këtij urdhri, për përbërësit e një *cuvée-je,* ndalohet çdo pasurim *cuvée.*

4. Megjithatë, për rajone dhe varietete për të cilat është teknikisht e justifikuar, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Vitivinikulturës, ministri mund të autorizojë pasurimin *cuvée* në vendin e përgatitjes së verërave të gazuara shkumbëzuese, me kusht që:

a) asnjë nga përbërësit *cuvée* nuk i është nënshtruar më parë pasurimit;

b) përbërësit e përmendur rrjedhin vetëm nga rrushi i vjelë në Shqipëri;

c) pasurimi kryhet një herë, me një operacion të vetëm;

ç) nuk kalon 1,5% vol.;

d) metoda e përdorur është shtimi i sakarozës, mushtit të rrushit të përqendruar ose mushtit të rrushit të përqendruar të korrigjuar.

5. Shtimi i *Tirage liqueur* dhe *Expedition liqueur* nuk konsiderohet as si pasurim as si ëmbëlsim. Shtimi i *Tirage liqueur* nuk shkakton rritje të fortësisë alkoolike totale sipas vëllimit *cuvée* me më shumë se 1,5% vol.

Kjo rritje matet duke llogaritur diferencën mes fortësisë alkoolike totale sipas vëllimit *cuvée* dhe fortësisë alkoolike totale sipas vëllimit të verës së gazuar shkumbëzuese përpara shtimit të ndonjë *Expedition liqueur*.

6. Shtimi i *Expedition liqueur* kryhet në një mënyrë që të mos rrisë fortësinë alkoolike efektive sipas vëllimit të verës së gazuar shkumbëzuese me më shumë se 0,5% vol.

7. Ëmbëlsimi *cuvée* dhe përbërësve të saj është i ndaluar.

8. Përveç çdo acidifikimi ose deacidifikimi të përbërësve *cuvée*, në përputhje me rregullat e këtij urdhri, *cuvée* mund t'i nënshtrohet acidifikimit ose deacidifikimit. Acidifikimi dhe deacidifikimi *cuvée* janë reciprokisht përjashtues ndaj njëri-tjetrit. Acidifikimi mund të kryhet vetëm deri në një maksimum prej 1,5 gram për litër, i shprehur si acid tartrik, pra 20 miliekvivalentë për litër.

9. Në vitet me kushte klimatike të jashtëzakonshme, kufiri maksimal prej 1,5 gram për litër ose 20 miliekvivalentë për litër mund të rritet në 2,5 gram për litër ose 34 miliekuivalentë për litër, me kusht që aciditeti natyror i produkteve të mos jetë më pak se 3 g/l, i shprehur si acid tartrik, ose 40 miliekvivalentë për litër.

10. Dyoksidi i karbonit në verërat e gazuara shkumbëzuese prodhohet vetëm si rezultat i fermentimit alkoolik *cuvée* nga e cila përgatitet një verë e tillë.

Një fermentim i tillë, përveç rasteve kur synohet për përpunimin e rrushit, mushtit të rrushit ose mushtit të rrushit pjesërisht të fermentuar në verë të gazuar shkumbëzuese, mund të rezultojë vetëm nga shtimi i *Tirage liqueur*. Ky proces mund të realizohet vetëm në shishe ose në enë të mbyllura.

Përdorimi i dyoksidit të karbonit në rastin e procesit të transferimit përmes kundërpresionit është i autorizuar nën mbikëqyrje dhe me kusht që shkëmbimet e pashmangshme të gazit me dyoksidin e karbonit nga fermentimi alkoolik *cuvée* të mos rrisin presionin e dyoksidit të karbonit të pranishëm në verërat e gazuara shkumbëzuese.

11. Në rastin e verërave të gazuara shkumbëzuese të ndryshme nga verërat e gazuara shkumbëzuese që kanë një emërtim origjine të mbrojtur:

a) *Tirage liqueur* i destinuar për përgatitjen e tyre mund të përmbajë vetëm:

i. musht rrushi;

ii. musht rrushi në fermentim;

iii. musht rrushi i përqendruar;

iv. musht rrushi i përqendruar i korrigjuar; ose

v. sakarozë dhe verë;

b) Fortësia alkoolike efektive sipas vëllimit, duke përfshirë alkoolin e përmbajtur në çdo *Expedition liqueur* të shtuar, duhet të jetë jo më pas se 9,5% vol.

B. VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE CILËSORE

1. *Tirage liqueur* i destinuar për prodhimin e një vere të gazuar shkumbëzuese cilësore mund të përmbajë vetëm:

a) sakarozë;

b) musht rrushi i përqendruar;

c) musht rrushi i përqendruar i korrigjuar;

d) musht rrushi ose musht rrushi pjesërisht i fermentuar; ose

e) verë.

2. Prodhimi i verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore bazohet, gjithashtu, në rregullat e përcaktuara në:

a) pikat 1 deri në 10, të pjesës A, të kësaj shtojce;

b) pikën 2, të pjesës C, të kësaj shtojce për fortësinë alkoolike efektive, pikën 4, të seksionit C, të kësaj shtojce për mbipresionin minimal dhe pikat 5 dhe 6, të seksionit C, të kësaj shtojce, për kohëzgjatjen minimale të procesit të prodhimit, pa rënë ndesh me shkronjën "ç", të pikës 3, të seksionit B, të kësaj shtojce.

3. Për sa u përket verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike:

a) përveç rasteve përjashtimore, ato mund të përftohen vetëm duke përdorur ekskluzivisht gjatë përgatitjes *cuvée* musht rrushi ose musht rrushi pjesërisht të fermentuar, të përftuar nga varietetet e verës të listuara në përputhje me shkronjën "a" të pikës 20.6 të nenin 2 të ligjit;

b) kontrolli i procesit të fermentimit përpara dhe pas përgatitjes *cuvée*, për ta bërë atë me gaz, mund të realizohet vetëm përmes ftohjes ose proceseve të tjera fizike;

c) shtimi *Expedition liqueur* është i ndaluar;

ç) kohëzgjatja e procesit të prodhimit për verërat e gazuara shkumbëzuese aromatike cilësore nuk është më pak se një muaj.

C. VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE DHE VERËRAT E GAZUARA SHKUMBËZUESE CILËSORE ME EMËRTIM ORIGJINE TË MBROJTUR

1. Fortësia alkoolike totale sipas vëllimit *cuvée* të destinuar për përgatitjen e verërave të gazuara

shkumbëzuese cilësore që mbajnë një emërtim origjine të mbrojtur nuk duhet të jetë më pak se 9% vol.

2. Fortësia alkoolike efektive sipas vëllimit në verëra të gazuara shkumbëzuese cilësore me emërtim origjine të mbrojtur, përfshirë alkoolin e përmbajtur në çdo *Expedition liqueur* të shtuar, nuk duhet të jetë më pak se 10% vol.

3. *Tirage liqueur* për verërat e gazuara shkumbëzuese dhe verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore me emërtim origjine të mbrojtur mund të përmbajë vetëm:

a) sakarozë;

b) musht rrushi i përqendruar;

c) musht rrushi i përqendruar i korrigjuar;

dhe:

a) musht rrushi;

b) musht rrushi pjesërisht i fermentuar;

c) verë,

të përshtatshme për të prodhuar të njëjtën verë të gazuar shkumbëzuese ose verë të gazuar shkumbëzuese cilësore me emërtim origjine të mbrojtur, të njëjtë me atë së cilës i shtohet *Tirage liqueur*.

4. Pavarësisht shkronjës "c", të nënpikës 20.5, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, kur ruhen në një temperaturë prej 20°C, në enë të mbyllura, me kapacitet më pak se 25 cl, verërat e gazuara cilësore me emërtim origjine të mbrojtur duhet të kenë një mbipresion, jo më pak se 3 bar.

5. Kohëzgjatja e procesit të prodhimit të verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore me emërtim origjine të mbrojtur, përfshirë vjetrimin në ndërmarrjen ku ato prodhohen dhe llogaritur nga fillimi i procesit të fermentimit të destinuar për t'i bërë verërat me gaz, nuk mund të jetë më pak se:

a) gjashtë muaj kur procesi i fermentimit i synuar për t'i bërë verërat me gaz ndodh në enë të mbyllura;

b) nëntë muaj kur procesi i fermentimit i synuar për t'i bërë verërat me gaz ndodh në shishe.

6. Kohëzgjatja e procesit të fermentimit të synuar për ta bërë *cuvée* me gaz dhe kohëzgjatja e pranisë *cuvée* mbi llumrat nuk duhet të jetë më pak se:

a) 90 ditë;

b) 30 ditë nëse fermentimi ndodh në enë me përzierës.

7. Rregullat e përcaktuara në pikat 1 deri në 10, të seksionit A, të kësaj shtojce, dhe pika 2, e seksionit B, të kësaj shtojce, zbatohen, gjithashtu, për verërat e gazuara shkumbëzuese dhe verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore me emërtim origjine të mbrojtur.

8. Për sa u përket verërave shumbëzuese të gazuara aromatike cilësore me emërtim origjine të mbrojtur:

a) këto verëra mund të përftohen vetëm duke përdorur, për përgatitjen *cuvée,* musht rrushi ose musht rrushi pjesërisht të fermentuar nga varietetet e rrushit të përfshira në listën e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 20.6, të nenin 2 të ligjit, me kusht që këto varietete të jenë të njohura si të përshtatshme për prodhimin e verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore, me emërtim origjine të mbrojtur në rajonin emrin e të cilit ato mbajnë;

b) kontrolli i procesit të fermentimit përpara dhe pas përgatitjes *cuvée,* për ta bërë atë me gaz, mund të realizohet vetëm përmes ftohjes ose proceseve të tjera fizike;

c) shtimi *Expedition liqueur* është i ndaluar;

d) fortësia alkoolike efektive sipas vëllimit të verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike me emërtim origjine të mbrojtur nuk mund të jetë më pak se 6% vol.;

e) fortësia alkoolike totale sipas vëllimit të verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike me emërtim origjine të mbrojtur nuk mund të jetë më pak se 10% vol.;

f) kur ruhen në një temperaturë prej 20°C në enë të mbyllura, verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike me emërtim origjine të mbrojtur duhet të kenë një mbipresion jo më pak se 3 bar;

g) pavarësisht pikës 6, të pjesës C, të kësaj shtojce, kohëzgjatja e procesit të prodhimit të verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike me emërtim origjine të mbrojtur nuk mund të jetë më pak se një muaj.

SHTOJCA III
PRAKTIKAT ENOLOGJIKE TË AUTORIZUARA DHE KUFIZIMET E ZBATUESHME PËR VERËRAT E FORTIFIKUARA LIKEROZE DHE VERËRAT E FORTIFIKUARA LIKEROZE ME EMËRTIM ORIGJINE TË MBROJTUR OSE TREGUES GJEOGRAFIK TË MBROJTUR

A. Verërat e fortifikuara likeroze

1. Produktet e përdorura për përgatitjen e verërave të fortifikuara likeroze dhe verërave të fortifikuara

likeroze me emërtim origjine të mbrojtur ose tregues gjeografik të mbrojtur i nënshtrohen, kur është e përshtatshme, vetëm praktikave dhe proceseve enologjike të parashikuara në këtë urdhër.

2. Në çdo rast, rritja e fortësisë alkoolike natyrale sipas vëllimit mund të vijë vetëm nga përdorimi i produkteve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 20.3, të nenit 2 të ligjit ose në pikën 1, të pjesës B, të kësaj shtojce.

3. Janë të autorizuara, gjithashtu:

a) ëmbëlsimi, i kushtëzuar nga kërkesa për deklarim dhe regjistrim, kur produktet e përdorura nuk janë pasuruar me musht rrushi të përqendruar, duke përdorur musht rrushi të përqendruar, ose musht rrushi të përqendruar të korrigjuar, me kusht që rritja e fortësisë alkoolike totale, sipas vëllimit të verës përkatëse të mos jetë më shumë se 3% vol.

b) shtimi i alkoolit ose distilatit, siç parashikohet në shkronjën "ç" të pikës 20.3, të nenit 2 të ligjit, për të kompensuar humbjet e shkaktuara nga avullimi gjatë vjetrimit.

4. Varietetet e rrushit për verë nga të cilat prodhohen produktet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 20.3, të nenit 2, të ligjit, të përdorura për përgatitjen e verërave të fortifikuara likeroze dhe verërave të fortifikuara likeroze me emërtim origjine të mbrojtur ose me tregues gjeografik të mbrojtur, duhet të përzgjidhen nga ato të parashikuara në nenin 10 të ligjit.

5. Fortësia alkoolike natyrale sipas vëllimit e produkteve të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 20.3, të nenit 2, të ligjit, të përdorura për përgatitjen e një vere të fortifikuar likeroze, përveç verërave të fortifikuara likeroze me emërtim origjine të mbrojtur ose me tregues gjeografik të mbrojtur, nuk mund të jetë më pak se 12% vol.

B. Verërat e fortifikuara likeroze me emërtim origjine të mbrojtur

1. Produktet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 20.3, të nenit 2, të ligjit, mushti i rrushit i përqendruar dhe mushti i rrushit pjesërisht i fermentuar i përftuar nga rrushi i thatë, i përdorur për përgatitjen e verës së fortifikuar likeroze, me emërtim origjine të mbrojtur, duhet të vijnë nga rajoni emrin e të cilit mban vera e fortifikuar likeroze, me emërtim të mbrojtur të origjinës në fjalë.

2. Produktet e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 20.3, të nenit 2, të ligjit dhe operacionet e përmendura në pikat 1 deri 4, të pjesës A, të kësaj shtojce, për përgatitjen e një vere të fortifikuar likeroze me emërtim origjine të mbrojtur kryhen vetëm brenda rajonit të përmendur në pikën 1 të kësaj pjese B të kësaj shtojce.

3. Ministri miraton përjashtime nga rregullat e përcaktuara në pjesën A, të kësaj shtojce, për verërat e fortifikuara likeroze me emërtim origjine të mbrojtur.

URDHËR
Nr. 806, datë 14.8.2025

PËR RREGULLAT SHTESË SPECIFIKE PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE TË VERËS[2]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 35, të ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën",

URDHËROJ:

Neni 1
Qëllimi

1. Ky urdhër përcakton rregullat shtesë specifike, në plotësim të rregullave për etiketimin dhe

[2] Ky urdhër është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/33, datë 17 tetor 2018, "Për plotësimin e Rregullores (BE) 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe termave tradicionalë në sektorin e verës, procedurën e kundërshtimit, kufizimet e përdorimit, ndryshimet në specifikimet e produktit, anulimi i mbrojtjes dhe etiketimi dhe prezantimi". Numri CELEX 32019R0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 9, datë 11.1.2019, f. 2–45.

- Rregulloren (BE) 2021/2117 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 2 dhjetor 2021, që ndryshon Rregulloret (BE) 1308/2013, për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore, (BE) 1151/2012, mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, (BE) 251/2014, për përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografikë të produkteve të verës së aromatizuar dhe (BE) 228/2013 që përcakton masa specifike për bujqësinë në rajonet më të largëta të Unionit, numri CELEX 32021R2117, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 435, datë 6.12.2021, f. 262–314.

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2023/1606, datë 30 maj 2023, që ndryshon Rregulloren e Deleguar (BE) 2019/33, për disa dispozita, në lidhje me emërtimet e mbrojtura të origjinës dhe treguesit gjeografikë të mbrojtur për verën dhe për paraqitjen e të dhënave të detyrueshme për produktet e hardhisë, si dhe rregullat specifike për tregimin dhe emërtimin e përbërësve për produktet e hardhisë, dhe Rregulloren e Deleguar (BE) 2018/273, përsa i përket certifikimit të produkteve të importuara të verës, numri CELEX 32023R1606, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 198, datë 8.8.2023, f. 6–13.

prezantimin e produkteve të sektorit të verës, të përcaktuara nga neni 30 deri në nenin 34, të ligjit nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

2. Këto rregulla specifike shtesë kanë të bëjnë me informacione të detyrueshme dhe jo të detyrueshme të etiketimit dhe paraqitjes së informacionit për konsumatorin, duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të sektorit të verës.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të zbatimit të këtyre rregullave, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) "mbushje" nënkupton vendosjen e produktit në fjalë në kontejnerë me një kapacitet jo më të madh se 60 litra për shitje të mëpasshme;

b) "importues" është çdo person fizik ose juridik ose një grup i këtyre personave, që sjellin dhe vënë në qarkullim produkte të verës, nga prodhues ose furnizues të huaj, për qëllime tregtare në përmbushje të kërkesave ligjore që lidhen me këtë veprimtari dhe këto produkte;

c) "shitës" është çdo person fizik ose juridik, ose një grup i këtyre personave, që nuk mbulohen nga përkufizimi i prodhuesit, që blen dhe më pas vë në qarkullim verërat e gazuara shkumbëzuese, verërat e gazifikuara shkumbëzuese, verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore ose verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore aromatike;

ç) "adresa" janë të dhënat e zonës administrative lokale dhe të vendit në të cilin ndodhet objekti ose zyra qendrore e mbushësit, prodhuesit, shitësit ose importuesit;

d) "ligj" është ligji nr. 86/2022, "Për vreshtarinë dhe verën";

dh) "VKM për etiketimin" është vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit".

Neni 3
Informacione të detyrueshme shtesë

Përveç informacioneve të detyrueshme të përcaktuara në nenin 31 të ligjit, etiketimi dhe paraqitja e produkteve të verës, të përkufizuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.11; 20.13; 20.15 dhe 20.16, të ligjit, që tregtohen brenda vendit ose eksportohen, përmbajnë informacione të detyrueshme shtesë të përcaktuara si më poshtë:

a) deklaratën e vlerave ushqyese, në përputhje me shkronjën "h", të pikës 1, të nenit 9, të VKM-së për etiketimin;

b) listën e përbërësve, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 9, të VKM-së për etiketimin;

c) datën e jetëgjatësisë minimale, në përputhje me shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 9, të VKM-së për etiketimin, në rastin e produkteve të rrushit, të cilat i janë nënshtruar një trajtimi dealkoolizimi, sipas urdhrit të ministrit të miratuar në përputhje me pikën 7, të nenit 13 të ligjit, dhe që kanë një fortësi alkoolike aktuale në vëllim më pak se 10%;

ç) volumin nominal;

d) numrin e lotit.

Neni 4
Paraqitja e informacioneve të detyrueshme

1. Informacionet e detyrueshme të përcaktuara në nenin 31, të ligjit dhe nenin 3, të këtij urdhri, duhet të shfaqen në të njëjtën fushëpamje mbi enë, në mënyrë të tillë që të jenë njëkohësisht të lexueshme, pa pasur nevojë të kthehet ena, me shkronja që nuk fshihen dhe duhet të jenë lehtësisht të dallueshme nga teksti ose grafika përreth.

2. Përjashtimisht nga rregullat e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 3 të këtij urdhri, deklarata e vlerave ushqyese në paketim ose në një etiketë të bashkëngjitur mund të reduktohet në paraqitjen, vetëm të vlerës së energjisë, e cila mund të shprehet duke përdorur simbolin "*E*" për energjinë. Në raste të tilla, deklarata e plotë e vlerave ushqyese jepet me mjete elektronike të identifikuara në paketim ose në një etiketë të bashkëngjitur. Kjo deklaratë e vlerave ushqyese nuk duhet të shfaqet bashkë me informacione të tjera me qëllime shitjeje ose marketingu, dhe nuk duhet të merren apo gjurmohen të dhënat e përdoruesit.

3. Përjashtimisht nga rregullimet e shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 3 të këtij urdhri, lista e përbërësve mund të sigurohet me mjete elektronike të identifikuara në paketim ose në një etiketë të bashkëngjitur. Në raste të tilla, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) nuk duhet të merren apo gjurmohen të dhënat e përdoruesit;

b) lista e përbërësve nuk duhet të shfaqet bashkë me informacione të tjera me qëllime shitjeje ose marketingu; dhe

c) çdo përbërës ose lëndë ndihmëse që shkakton alergji ose intolerancë, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 9, të VKM-së, për etiketimin duhet të shfaqet drejtpërdrejt në paketim ose në një etiketë të bashkëngjitur. Ky tregues do të përmbajë fjalën "përmban" e ndjekur nga emri i substancës ose produktit të renditur në shtojcën II, të VKM-së për etiketimin.

4. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, informacionet e detyrueshme të mëposhtme mund të shfaqen jashtë fushëpamjes së referuar në atë pikë:

a) substancat ose produktet që shkaktojnë alergji ose intoleranca, në përputhje me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 9, të VKM-së për etiketimin, kur lista e përbërësve jepet përmes mjeteve elektronike;

b) të dhënat e importuesit;

c) numri i lotit; dhe

ç) data e jetëgjatësisë minimale.

5. Madhësia e shkronjave të të dhënave të përmendura në pikën 1, të këtij neni dhe në pikën 1, të nenit 5, të këtij urdhri, duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 1,2 mm, pavarësisht nga stili i shkrimit të përdorur.

Neni 5
Termat për zbatimin e rregullave horizontale

1. Për qëllimin e paraqitjes së substancave ose produkteve të caktuara që shkaktojnë alergji ose intoleranca, në përputhje me nenin 21, të VKM-së, për etiketimin, termat që përdoren në lidhje me sulfite, vezë dhe produkte me bazë veze, qumësht dhe produkte me bazë qumështi, në zbatim të shkronjës "c", të pikës 3, të nenit 4 të këtij urdhri, janë si më poshtë:

a) termat që lidhen me sulfite: janë "sulfite" ose "anhidrid sulfuror";

b) termat që lidhen me vezë dhe produkte me bazë veze: janë "vezë", "proteina veze", "derivate veze", "lizozimë veze" ose "albuminë veze";

c) termat që lidhen me qumësht dhe produkte me bazë qumështi: janë "qumësht", "derivate qumështi", "kazeina qumështi" ose "proteina qumështi".

2. Termat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të shoqërohen nga piktogrami përkatës i paraqitur në shtojcën I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

Neni 6
Marketingu dhe eksporti

1. Produktet e rrushit për verë, etiketa ose prezantimi i të cilave nuk është në përputhje me kushtet përkatëse të përcaktuara në këtë urdhër, nuk tregtohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe as eksportohen jashtë saj.

2. Përjashtimisht nga rregullimet e parashikuara në nenet 21 dhe 22, të kreut V të ligjit, kur produktet e rrushit për verë do të eksportohen, institucioni përgjegjës për kontrollet mund të lejojë të dhëna dhe paraqitje që bien ndesh me rregullat në fuqi të etiketimit dhe prezantimit të produkteve të rrushit për verë, nëse këto të dhëna ose kjo paraqitje e produkteve kërkohet nga legjislacioni i vendit ku do të eksportohet.

3. Përjashtimisht nga rregullimet e parashikuara në nenet 21 dhe 22, të kreut V të ligjit, kur produktet e rrushit për verë do të konsumohen në bordet e avionëve, institucioni përgjegjës për kontrollet mund të lejojë paraqitje që bien ndesh me rregullat në fuqi të paraqitjes, nëse prezantime të tilla të produkteve të rrushit për verë janë të nevojshme për arsye sigurie.

Neni 7
Ndalimi i kapsulave ose fletëve me bazë plumbi

Pajisjet e mbylljes për produktet e rrushit për verë, të referuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.11, 20.13, 20.15 dhe 20.16, të pikës 20 të ligjit, nuk duhet të vishen me kapsula ose fletë me bazë plumbi.

Neni 8
Fortësia alkoolike aktuale

1. Fortësia alkoolike aktuale sipas vëllimit, e përmendur në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 31 të ligjit, duhet të tregohet në njësi ose gjysmënjësi përqindjeje.

Shifra duhet të ndiqet nga simboli "% vol." dhe mund të paraprihet nga fjalët "fortësia alkoolike

aktuale", "alkool aktual" ose "alk.". Për sa i përket mushtit të rrushit pjesërisht të fermentuar ose verës së re ende në fermentim, treguesi i fortësisë alkoolike aktuale mund të zëvendësohet ose plotësohet nga shifra e forcës alkoolike totale e ndjekur nga simboli "% vol." dhe paraprirë nga fjalët "fortësia alkoolike totale" ose "alkool total".

2. Për produktet që kanë kaluar në një proces dealkoolizimi, në etiketë shfaqen termat e mëposhtëm:

a) "pa alkool" për verërat ku fortësia alkoolike aktuale nuk është më e lartë se 0,5% në vëllim;

b) "me alkool të reduktuar" për verërat ku fortësia alkoolike aktuale është mbi 0.5% në volum dhe më e ulët se fortësia alkoolike aktuale minimale e kategorisë përkatëse përpara dealkoolizimit.

3. Pa rënë ndesh me tolerancat e përcaktuara për metodën referencë të analizës së përdorur, fortësia e treguar nuk mund të ndryshojë me më shumë se 0,5 % vol. nga ajo e dhënë nga analiza. Megjithatë, fortësia alkoolike e produkteve të rrushit për verë me emërtime origjine ose tregues gjeografikë të mbrojtur, të ruajtur në shishe për më shumë se tre vjet, verërat e gazuara shkumbëzuese, verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore, verërat e gazifikuara shkumbëzuese, verërat pjesërisht të gazuara, verërat e gazifikuara, verërat e fortifikuara likeroze dhe verërat nga rrushi i tejpjekur, pa rënë ndesh me tolerancat e përcaktuara për metodën referencë të analizës së përdorur, nuk mund të ndryshojnë me më shumë se 0,8 % vol. nga ajo e dhënë nga analiza.

Neni 9
Treguesi i prejardhjes

1. Për treguesin e prejardhjes, siç referohet në shkronjën "d", pika 1, të nenit 31 të ligjit, për produktet e rrushit për verë, të përmendura në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1, 20.3 deri në 20.9, 20.15 dhe 20.16 të ligjit, do të përdoren fjalët "verë (...)", "prodhuar në (...)", "produkt (...)", ose do të shprehen në terma të barasvlershëm të plotësuar me emrin e shtetit ku rrushi vilet dhe kthehet në verë.

2. Për treguesin e prejardhjes, siç referohet në shkronjën "d", pika 1, të nenit 31 të ligjit, për produktet e rrushit për verë të përmendura në nënpikat 20.2, 20.10, 20.11 dhe 20.13, të pikës 20, të nenit 2 të ligjit, do të përdoren fjalët "musht (…)" ose "musht i prodhuar në (...)" ose të shprehur në terma të barasvlershëm, të plotësuar me emrin e shtetit.

Neni 10
Treguesi i mbushësit, prodhuesit, importuesit dhe shitësit

1. Emri dhe adresa e mbushësit plotësohet:

a) me fjalët "mbushës" ose "mbushur nga (...)/futur në shishe nga (…)", që mund të plotësohen me terma që i referohen shoqërisë prodhuese; ose

b) sipas emërtimeve ku bëhet mbushja e produkteve të rrushit me emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur:

i. në stabilimentin e prodhuesit; ose

ii. në ambientet e një grupi prodhuesish; ose

iii. në një ndërmarrje të vendosur brenda ose në afërsi të zonës së caktuar gjeografike në fjalë.

Në rastin e mbushjes së shisheve mbi bazë të një kontrate, treguesi i mbushësit do të plotësohet me fjalët "mbushur për (...)/futur në shishe për (..)" ose me fjalët "mbushur për (...)/futur në shishe për (..) nga (...)" ku tregohet emri, adresa e personit që ka kryer mbushjen në emër të një pale të tretë.

Kur mbushja e shisheve kryhet në një vendndodhje tjetër nga ajo e mbushësit, të dhënat e përmendura në këtë paragraf shoqërohen me një referencë për vendin e saktë ku është kryer veprimi. Këto kërkesa nuk zbatohen kur mbushja e shisheve kryhet në një vendndodhje të afërt me atë të mbushësit.

Në rastin e enëve të ndryshme nga shishet, fjalët "paketues" dhe "paketuar nga (...)" do të zëvendësojnë përkatësisht fjalët "mbushës" ose "mbushur nga (...)/futur në shishe nga (…)".

2. Emri dhe adresa e prodhuesit ose shitësit do të plotësohen me termat "prodhues" ose "prodhuar nga" dhe "shitës" ose "shitur nga", ose terma të tjerë të barasvlershëm.

3. Emri dhe adresa e importuesit duhen paraprirë nga fjalët "importues" ose "importuar nga (...)". Për produktet e rrushit për verë të importuara të hapura, dhe të paketuara në Shqipëri, emri i importuesit mund të zëvendësohet ose plotësohet me treguesin e mbushësit, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

4. Treguesit e përmendur në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të grupohen së bashku nëse kanë të bëjnë me të njëjtin person fizik ose juridik.

5. Kur emri ose adresa e mbushësit, prodhuesit, importuesit ose shitësit përbëhet nga, ose përmban një emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur, ai duhet të shfaqet në etiketë me karaktere që nuk janë më shumë se gjysma e madhësisë së atyre të përdorura për emërtimin e origjinës ose treguesit gjeografik të mbrojtur, ose për përcaktimin e kategorisë së produktit të rrushit për verë në fjalë.

Neni 11

Treguesi i përmbajtjes së sheqerit për verën e gazuar shkumbëzuese, verën e gazifikuar shkumbëzuese, verën e gazuar shkumbëzuese cilësore ose verën e gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike

1. Termat që tregojnë përmbajtjen e sheqerit, që do të shfaqen në etiketën e produkteve të rrushit për verë, të parashikuar në shkronjën "ë", të nenin 31 të ligjit, janë sipas tabelave të shtojcës II, pjesë përbërëse të këtij urdhri.

2. Nëse përmbajtja e sheqerit në produktet e rrushit për verë, e shprehur si fruktozë, glukozë dhe sakarozë, justifikon përdorimin e dy prej termave të renditur në tabelën A, të shtojcës II, pjesë përbërëse të këtij urdhri, do të zgjidhet vetëm njëri prej këtyre dy termave.

3. Pa rënë në kundërshtim me kushtet e përdorimit të përshkruara në tabelën A, të shtojcës II, pjesë përbërëse të këtij urdhri, përmbajtja e sheqerit nuk mund të ndryshojë me më shumë se 3 gram për litër nga ajo që tregohet në etiketën e produktit.

Neni 12

Rregulla specifike për verëra të gazifikuara shkumbëzuese dhe verëra të gazifikuara

Termat "verë e gazifikuar shkumbëzuese" dhe "verë e gazifikuar", siç referohen në pikën 20, të nenit 2 të ligjit, do të plotësohen me karaktere të të njëjtit lloj dhe madhësi me fjalët "përfituar duke shtuar dioksid karboni" ose "përfituar duke shtuar anhidrid karboni", edhe kur zbatohet shkronja "a", e pikës 2, të neni 31 të ligjit.

Neni 13

Lista e përbërësve

1. Termi "rrush" përdoret për të zëvendësuar treguesin e rrushit dhe/ose mushtit të rrushit që përdoret si lëndë e parë për prodhimin e produkteve të rrushit për verë.

2. Termi "musht i përqendruar rrushi" përdoret për të zëvendësuar treguesin e mushtit të përqendruar të rrushit dhe/ose të mushtit të përqendruar të retifikuar të rrushit që përdoret për prodhimin e produkteve të rrushit për verë.

3. Kategoritë e substancave enologjike, emrat dhe Numrat Evropian (*E numbers*) që do të përdoren në listën e përbërësve përcaktohen në urdhrin e ministrit, të miratuar në përputhje me pikën 7, të nenit 13, të ligjit.

4. Pa rënë ndesh me pikën 1, të nenit 5 të këtij urdhri, termat që do të përdoren për të treguar substancat enologjike që shkaktojnë alergji ose intolerancë në listën e përbërësve, përcaktohen në urdhrin e ministrit të miratuar në përputhje me pikën 7, të nenit 13 të ligjit.

5. Aditivët nën kategoritë "rregullatorë të aciditetit" dhe "agjentë stabilizues", të cilët janë të ngjashëm ose reciprokisht të zëvendësueshëm, tregohen në listën e përbërësve duke përdorur shprehjen "përmban... dhe/ose", të ndjekur nga jo më shumë se tre aditivë, ku të paktën një prej tyre është i pranishëm në produktin përfundimtar.

6. Treguesi i aditivëve që i përkasin kategorisë "gazra ambalazhimi" në listën e përbërësve mund të zëvendësohet me frazën "të ambalazhuar në atmosferë mbrojtëse" ose "mbushja mund të ndodhë në një atmosferë mbrojtëse".

7. Shtimi i *tirage liqueur* dhe i *expedition liqueur* në produktet e rrushit mund të tregohet nga të dhënat specifike "*tirage liqueur*" dhe "*expedition liqueur*", të vetme ose të shoqëruara në kllapa, nga një listë e përbërësve të tyre, siç përcaktohet në urdhrin e ministrit të miratuar në përputhje me pikën 7, të nenit 13 të ligjit.

Neni 14

Emri i produktit

1. Përveç informacioneve jo të detyrueshme, të përmendura në nenin 32 të ligjit, shtohet edhe emri i produktit.

2. Emri i produktit mund të përfshijë emrin e markës ose një varietet, ose stil të veçantë të verës sipas përcaktimeve të këtij kreu dhe legjislacionit në fuqi për etiketimin dhe informimin e konsumatorit.

Neni 15
Viti i vjeljes

1. Viti i vjeljes, i përmendur në pikën 1, të nenit 32 të ligjit, shfaqet në etiketat e produkteve të rrushit për verë, të përkufizuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 11, 20.13, 20.15 dhe 20.16, 2 të ligjit, me kusht që të paktën 85% e rrushit për verë të përdorur për prodhimin e këtyre produkteve është vjelë në vitin në fjalë. Kjo nuk përfshin:

a) çdo sasi të produkteve të rrushit për verë të përdorura për ëmbëlsim, si *"tirage liqueur"* ose *"expedition liqueur";* ose

b) çdo sasi të verës së fortifikuar likeroze.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, prodhimet e rrushit për verë që nuk kanë emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur, por që mbajnë treguesin e vitit të vjeljes në etiketën e tyre, certifikohen në përputhje me nenin 36 të ligjit.

3. Për produktet e rrushit për verë të përftuara tradicionalisht nga rrushi i vjelur në janar ose shkurt, viti i vjeljes që shfaqet në etiketën e tyre është ai i vitit kalendarik paraardhës.

Neni 16
Emri i varietetit të rrushit

1. Emrat e varieteteve të rrushit për verë ose sinonimet e tyre të përmendura në pikën 2, të nenit 32 të ligjit, të përdorura për prodhimin e produkteve të rrushit për verë të përkufizuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri 20.11, 20.13, 20.15 dhe 20.16, pika 20 të ligjit, shfaqen në etiketën e këtyre produkteve sipas kushteve të përcaktuara më poshtë në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, nëse ato prodhohen në Shqipëri ose sipas kushteve të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "c" të kësaj pike, nëse prodhohen në një vend tjetër.

a) Emrat e varieteteve të rrushit për verë ose sinonimet e tyre mund të tregohen në kushtet e mëposhtme:

i. nëse emërtohet vetëm një varietet i rrushit për verë ose sinonimi i tij, të paktën 85% e produktit duhet të jetë bërë nga ai varietet, pa përfshirë:

- çdo sasi të produkteve të rrushit për verë të përdorura për ëmbëlsim, si *"tirage liqueur"* ose *"expedition liqueur";* ose

- çdo sasi të verës së fortifikuar likeroze;

ii. nëse emërtohen dy ose më shumë varietete rrushi për verë ose sinonimet e tyre, 100% e produktit në fjalë duhet të jetë bërë nga këto varietete, duke mos përfshirë:

- çdo sasi të produkteve të produkteve të rrushit për verë të përdorura për ëmbëlsim, si *"tirage liqueur"* ose *"expedition liqueur";* ose

- çdo sasi të verës së fortifikuar likeroze.

Varietetet e rrushit për verë shfaqen në etiketë në rend zbritës sipas sasisë së përdorur dhe me karaktere të së njëjtës madhësi;

b) Për produktet e rrushit për verë të prodhuara në Shqipëri, emrat e varieteteve të rrushit për verë ose sinonimet e tyre janë ato të përcaktuara në urdhrin e ministrit që bën klasifikimin e varieteteve të rrushit për verë, të miratuar në përputhje me pikën 3, të nenit 10 të ligjit;

c) Për produktet e rrushit me origjinë nga vendet e tjera, kushtet e përdorimit të emrave të varieteteve të rrushit për verë ose sinonimeve të tyre duhet të jenë në përputhje me rregullat e zbatueshme për prodhuesit e verës në vendin në fjalë, duke përfshirë ato që vijnë nga organizata përfaqësuese profesionale, dhe emrat e varietetet e rrushit për verë ose sinonimet e tyre duhet të jenë ato të specifikuara në listën e të paktën një prej organizatave të mëposhtme:

i. Organizata Ndërkombëtare e Vreshtave dhe Verës – OIV (*International Organisation of Vine and Wine*);

ii. Bashkimi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve – UPOV; (*International Union for the Protection of New Varieties of Plants*);

iii. Bordi Ndërkombëtar për Resurset Gjenetike të Bimëve IBPGR (*International Board for Plant Genetic Resources*).

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, një produkt i rrushit për verë që nuk ka emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur, por ka një tregues të varietetit të rrushit në etiketën e tij, certifikohet sipas nenit 36 të ligjit.

Në rastin e verërave të gazuara shkumbëzuese dhe verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore, emrat e varieteteve të rrushit të verës që përdoren për të plotësuar përshkrimin e produktit, përkatësisht *"pinot blanc", "pinot noir" "pinot meunier"*

ose *"pinot gris"* dhe emra të tjerë ekuivalent, mund të zëvendësohet me sinonimin *"pinot"*.

Neni 17

Rregulla specifike për tregimin e varieteteve të rrushit për verë në produktet e rrushit për verë që nuk kanë një emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur

Për produktet e rrushit për verë të përkufizuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.9 dhe 20.16 të ligjit, që nuk kanë emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur dhe me kusht që të respektohen kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit, termi "verë varietore" mund të plotësohet nga një ose të dyja shtesat e mëposhtme:

a) shqiptare;

b) emri i varietetit/varieteteve të rrushit.

Neni 18

Tregimi i përmbajtjes së sheqerit për produktet e rrushit për verë, përveç verës së gazuar shkumbëzuese, verës së gazifikuar shkumbëzuese, verës së gazuar shkumbëzuese cilësore ose verës së gazuar shkumbëzuese aromatike cilësore

1. Përmbajtja e sheqerit e shprehur si fruktozë dhe glukozë, sipas tabelës B, të shtojcës II, të këtij urdhri, mund të shfaqet në etiketën e produkteve të rrushit për verë, përveç rastit të verës së gazuar shkumbëzuese, verës së gazifikuar shkumbëzuese, verës së gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike, për të cilin treguesi i përmbajtjes së sheqerit është i detyrueshëm në përputhje me shkronjën "ë", të nenit 31 të ligjit.

2. Kur përmbajtja e sheqerit në produktet e rrushit për verë justifikon përdorimin e dy prej termave të tabelës B, të shtojcës II, të këtij urdhri, do të zgjidhet vetëm njëri prej këtyre dy termave.

3. Pa rënë ndesh me kushtet e përdorimit të përshkruara në tabelën B, të shtojcës II, të këtij urdhri, përmbajtja e sheqerit nuk mund të ndryshojë me më shumë se 1 gram për litër nga ajo që shfaqet në etiketën e produktit.

Neni 19

Termat që i referohen metodave të caktuara të prodhimit

1. Në përputhje me pikën 6, të nenit 32 të ligjit, produktet e rrushit të përkufizuara në nenin 2, pika 20, nënpikat 20.1 deri në 20.11, 20.13, 20.15 dhe 20.16, të ligjit, mund të kenë tregues që i referohen metodave të caktuara të prodhimit. Këto tregues përfshijnë metodat e prodhimit të përmendura në këtë nen, të këtij urdhri.

2. Vetëm termat e përdorur për t'iu referuar treguesve të disa metodave të prodhimit të renditura në tabelën C, të shtojcës II, të këtij urdhri do të përdoren për të përshkruar një produkt rrushi për verë që është fermentuar, maturuar ose të vjetruara në një enë druri.

Treguesit që i referohen metodave të caktuara të prodhimit nuk mund të përdoren për të përshkruar një produkt rrushi për verë që është prodhuar me ndihmën e copëzave *(chips-ave)* të lisit, edhe në rastin kur kombinohet me qëndrimin në enë prej druri.

3. Shprehja "fermentuar në shishe" ose "me fermentim në shishe" mund të përdoret vetëm për të përshkruar verërat shkumbëzuese që kanë një emërtim origjine ose një tregues gjeografik të mbrojtur të një vendi tjetër ose verërat shkumbëzuese cilësore, me kusht që:

a) produkti është bërë i gazuar si pasojë e një fermentimi të dytë alkoolik në një shishe;

b) kohëzgjatja e procesit të prodhimit, duke përfshirë vjetërimin në ndërmarrjen ku është bërë produkti, e llogaritur që nga fillimi i procesit të fermentimit të projektuar për ta bërë *cuvée*-në shkumbëzuese, nuk ka qenë më pak se nëntë muaj;

c) procesi i fermentimit i projektuar për ta bërë *cuvée*-në shkumbëzuese dhe qëndrimi i *cuvée*-së me llumrat ka zgjatur të paktën 90 ditë;

ç) produkti ndahet nga llumrat duke u filtruar në përputhje me metodën e tërheqjes ose me metodën *dégorgement*.

4. Shprehjet "fermentuar në shishe me metodën tradicionale" ose "metodë tradicionale", ose "metodë klasike", ose "metodë klasike tradicionale", mund të përdoren vetëm për të përshkruar verërat shkumbëzuese që mbajnë një emërtim origjine ose një tregues gjeografik të mbrojtur të një vendi tjetër ose verërat shkumbëzuese cilësore, me kusht që produkti:

a) është bërë i gazuar si pasojë e një fermentimi të dytë alkoolik në një shishe;

b) ka qëndruar pa ndërprerje në kontakt me llumrat për të paktën nëntë muaj, në të njëjtën ndërmarrje, që nga koha kur u krijua *cuvee*-ja;

c) është ndarë nga llumrat me metodën *dégorgement.*

5. Shprehja *"Crémant"* mund të përdoret vetëm për verërat e gazuara shkumbëzuese cilësore të bardha ose *"rozë/rosé"* që kanë një emërtim origjine ose një tregues gjeografik të mbrojtur me kusht që:

a) rrushi të jetë vjelë me dorë;

b) vera bëhet nga mushti i përftuar nga shtypja e rrushit të plotë ose me frenja të hequra. Sasia e mushtit të përftuar nuk kalon 100 litra për çdo 150 kg rrush;

c) përmbajtja maksimale e dioksidit të squfurit nuk kalon 150 mg/l;

ç) përmbajtja e sheqerit është më pak se 50 g/l;

d) vera është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni.

Pa rënë ndesh me nenin 21 të këtij urdhri, termi *"Crémant"* do të tregohet në etiketat e verërave të gazuara shkumbëzuese cilësore në kombinim me emrin e njësisë gjeografike që qëndron në bazë të zonës së përcaktuar të emërtimit të origjinës ose një tregues gjeografik të mbrojtur të një vendi të tretë në fjalë.

6. Referencat për prodhimin organik të rrushit rregullohen në përputhje me legjislacionin për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre.

7. Terma të tjerë referuar metodave specifike të prodhimit mund të aplikohen për produkte me emërtim origjine ose tregues gjeografik të mbrojtur, vetëm nëse kushtet e përdorimit të këtyre termave janë të referuara në protokollet e prodhimit të produkteve në fjalë.

Neni 20

Tregimi i njësisë prodhuese

1. Termat si "vila", "bodrumi", "qilari", "kulla", "rezidenca", "kështjella" etj., që i referohen një njësie prodhuese, të ndryshme nga emri i mbushësit, prodhuesit ose shitësit, rezervohen për produktet e rrushit për verë me emërtime origjine ose tregues gjeografikë të mbrojtur.

2. Këta terma përdoren vetëm nëse produkti i rrushit për verë është bërë ekskluzivisht nga rrushi i vjelë në vreshtat e shfrytëzuara nga ajo njësi dhe prodhimi i verës kryhet tërësisht në atë njësi.

3. Operatorët e përfshirë në tregtimin e produktit të rrushit për verë të prodhuar në një njësi të tillë përdorin emrin e njësisë për etiketimin dhe prezantimin e atij produkti rrushi vetëm nëse njësia në fjalë jep pëlqimin me atë përdorim.

Neni 21

Referenca për emra të njësive gjeografike më të vogla ose më të mëdha se zona në bazë të emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik të mbrojtur

1. Bazuar në pikën 7, të nenit 32 të ligjit dhe në përputhje me nenet 7 dhe 8 të këtij urdhri, vetëm një produkt i rrushit për verë që ka një emërtim origjine të mbrojtur ose një tregues gjeografik të mbrojtur, mund të përmbajë në etiketë një referencë për emrin, të një njësie gjeografike që është më e vogël ose më e madhe se zona e atij emërtimi të origjinës ose treguesi gjeografik.

2. Kur bëhet referencë në emrat e njësive gjeografike që janë më të vogla se zona që qëndron në bazë të emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik, zona e njësisë gjeografike në fjalë përcaktohet qartë në specifikimet e produktit nga aplikanti i skemës së cilësisë.

Për produktet e rrushit për verë të prodhuara në një njësi më të vogël gjeografike, duhet që:

a) të paktën 85 % e rrushit nga i cili është prodhuar produkti i rrushit për verë duhet të jetë me origjinë nga ajo njësi më e vogël gjeografike. Këtu nuk përfshihet:

- çdo sasi e produkteve të produkteve të rrushit për verë të përdorura për ëmbëlsim, si *"tirage liqueur"* ose *"expedition liqueur";* ose

- çdo sasi e verës së fortifikuar likeroze;

b) pjesa e mbetur e rrushit për verë të përdorur në prodhim duhet të jetë me origjinë nga zona e përcaktuar gjeografike e emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik në fjalë.

3. Emri i një njësie gjeografike më të vogël ose më të madhe se zona në bazë të emërtimit të origjinës ose treguesit gjeografik ose treguesve të një zone gjeografike duhet t'i referohet:

a) një lokaliteti ose grup lokalitetesh;

b) një zone administrative lokale ose një pjesë të saj;

c) një nënrajoni të prodhimit të verës ose pjesë e tij;

ç) një zone administrative.

Neni 22

Rregulla për paraqitjen e produkteve të caktuara të rrushit për verë

1. Vera e gazuar shkumbëzuese, vera e gazuar shkumbëzuese cilësore dhe vera e gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike e prodhuar brenda Shqipërisë tregtohet ose eksportohet në shishe qelqi të tipit "verë shkumbëzuese" të mbyllura për:

a) shishet me vëllim nominal më shumë se 0,20 litra: një tapë në formë kërpudhe e bërë prej tape ose materiali tjetër që lejohet të bjerë në kontakt me produktet ushqimore, e fiksuar me një mbërthesë, nëse është e nevojshme e mbuluar me një kapak dhe e mbështjellë me fletë metalike që mbulon plotësisht tapën dhe të gjithë ose një pjesë të qafës së shishes;

b) shishet me një vëllim nominal që nuk kalon 0,20 litra, çdo mbyllje tjetër e përshtatshme.

Pijet e tjera të prodhuara në Shqipëri nuk tregtohen ose eksportohen as në shishe qelqi të tipit "verë shkumbëzuese" ose me mbyllje siç përshkruhet në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni.

2. Përjashtimisht nga rregullimet e shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, prodhuesit e verës së gazuar shkumbëzuese, verës së gazuar shkumbëzuese cilësore dhe verës së gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike mund të zgjedhin të mos e mbështjellin mbërthesën me një fletë metalike.

Neni 23

Institucionet që ngarkohen

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

SHTOJCA I

Piktogram që mund të paraqitet në etiketë për informimin në lidhje me substanca të caktuara alergjenë, sipas pikës 2, të nenit 5 të këtij urdhri.



SHTOJCA II

Tabela A. Treguesi i përmbajtjes së sheqerit për verën e gazuar shkumbëzuese, verën e gazifikuar shkumbëzuese, verën e gazuar shkumbëzuese cilësore ose verën e gazuar shkumbëzuese cilësore aromatike, sipas nenit 11 të këtij urdhri.

Termi	Kushti i përdorimit sipas sasisë së sheqerit në verë
"Brut natyral"	Nëse përmbajtja e sheqerit është më pak se 3 gram për litër; ky term përdoret vetëm për produktet të cilave nuk u është shtuar sheqer pas fermentimit dytësor.
"Ekstra brut" ose "extra brut"	Nëse përmbajtja e sheqerit është midis 0 dhe 6 gram për litër.
"Brut"	Nëse përmbajtja e sheqerit është më pak se 12 gram për litër.
"Ekstra e thatë" ose "extra sec"	Nëse përmbajtja e sheqerit është midis 12 dhe 17 gram për litër.
"E thatë" ose "sec"	Nëse përmbajtja e sheqerit është midis 17 dhe 32 gram për litër.
"Gjysmë e thatë" ose "demi sec"	Nëse përmbajtja e sheqerit është midis 32 dhe 50 gram për litër.
"E ëmbël" ose "doux"	Nëse përmbajtja e sheqerit është më e madhe se 50 gram për litër.

Tabela B. Termat që shfaqen në etiketë mbi përmbajtja e sheqerit e shprehur si fruktozë dhe glukozë në produkteve të rrushit për verë, sipas nenit 18 të këtij urdhri.

Termi	Kushti i përdorimit sipas sasisë së sheqerit në verë
"E thatë"	Përmbajtja e sheqerit nuk kalon: - 4 gram për litër; - 9 gram për litër, me kusht që aciditeti total i shprehur në gram acid tartarik për litër të mos jetë më shumë se 2 gram nën përmbajtjen e sheqerit të mbetur; - 15 gram për litër, vetëm për verërat pjesërisht të gazuara ose verërat e gazifikuara; - 40 gram për litër, vetëm për verërat e fortifikuara likeroze.
"Gjysmë e thatë"	Përmbajtja e sheqerit tejkalon maksimumin e lejuar për verërat e thata, por: - nuk kalon 12 gram për litër; ose - nuk kalon 18 gram për litër, me kusht që aciditeti total i shprehur në gram acid tartarik për litër të mos jetë më shumë se 10 gram nën përmbajtjen e sheqerit të mbetur; - është nga 12 deri në 35 gram për litër, vetëm për verërat pjesërisht të gazuara ose verërat e gazifikuara; - është nga 40 deri në 100 gram për litër, vetëm për verërat e fortifikuara likeroze.

"Gjysmë e ëmbël" ose "e dashur"	Përmbajtja e sheqerit tejkalon maksimumin e lejuar për verërat gjysmë të thata, por: - nuk kalon 45 gram për litër; - është nga 30 deri në 50 gram për litër vetëm për verërat pjesërisht të gazuara ose verërat e gazifikuara; - është nga 40 deri në 100 gram për litër, vetëm për verërat e fortifikuara likeroze
"E ëmbël"	Përmbajtja e sheqerit është të paktën: - 45 gram për litër; - 100 gram për litër, vetëm për verërat e fortifikuara likeroze.

Tabela C. Termat që shfaqen në etiketë për t'iu referuar treguesve të disa metodave të prodhimit, për të përshkruar një produkt rrushi për verë që është fermentuar, maturuar ose të vjetruara në një enë druri, sipas pikës 2, të nenit 19 të këtij urdhri.

Termi	Kushtet e përdorimit
"Fermentuar në fuçi … (trego llojin e drurit)" ose "fermentuar në fuçi druri"	Vera ka kryer fermentimin në fuçi druri.
"Maturuar në fuçi … (trego llojin)" ose "maturuar në fuçi druri"	Vera është maturuar në fuçi druri për minimumi 3 muaj.
"Vjetëruar në fuçi … (trego llojin)" ose "vjetëruar në fuçi druri"	Vera është vjetëruar në fuçi druri për minimumi 6 muaj.
"Rezervë" ose "rezerva"	Për verërat e kuqe: minimumi 2 vjet maturim, nga të cilat minimumi 6 muaj në fuçi druri.
	Për verërat e bardha: minimumi 1 vit maturim.
	Për verërat shkumbëzuese të prodhuara me "metodën *Charmat*": minimumi 1 vit maturim.
	Për verërat shkumbëzuese të prodhuara me "metodën klasike": minimumi 2 vjet maturim.

URDHËR
Nr. 807, datë 14.8.2025

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS SË CERTIFIKATËS PËR EKSPORT PËR PRODUKTET E VERËS[3]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 5, të nenit 40, të ligjit nr. 86, datë 22.12.2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së certifikatës për eksport që shoqëron produktet e verës, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas formatit në shtojcën I, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Informacionet e rubrikave brenda formatit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, plotësohen sipas shpjegimeve të shtojcës IA, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatës së eksportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, është Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

4. Për produktet e verës me destinacion eksportin në vendet e Bashkimit Evropian, entet dhe laboratorët e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lëshimin e certifikatës VI-1, certifikatë e detyrueshme për eksport në vendet e BE-së, përdorin edhe formatin në shtojcën II, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Informacionet e rubrikave brenda formatit plotësohen sipas shpjegimeve të shtojcës IIA, bashkëlidhur këtij urdhri.

6. Autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatës së eksportit për vendet e Bashkimit Evropian, sipas formatit në shtojcën II të këtij urdhri, është institucioni përgjegjës për kontrollet, i përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 86, datë 22.12.2022, "Për vreshtarinë dhe verën".

7. Certifikata për eksport plotësohet nga dorëzuesi ose një person i autorizuar prej tij dhe që vepron në emër të dorëzuesit.

8. Certifikata e eksportit është në gjuhën angleze, sipas formateve të miratuara në këtë urdhër dhe parashikimeve të legjislacionit të BE-së.

9. Ngarkohet institucioni përgjegjës për kontrollet dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

[3] Ky urdhër është përafruar pjesërisht me:

-Rregulloren (BE) nr. 1308/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013, "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007", e ndryshuar. Numri CELEX 32013R1308, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë 20.12.2013, f .671 - 854;

- Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2018/273 e 11 dhjetor 2017 e cila plotëson Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrit të hyrjeve dhe daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimet e informacionit të njoftuar dhe plotësimin e rregullores së BE nr. 1306/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kontrollet dhe sanksionet përkatëse, ndryshimit të rregulloreve të Komisionit (KE) nr. 555/2008, (KE) nr. 606/2009 dhe (KE) nr. 607/2009 dhe shfuqizimit të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 436/2009 dhe Rregullores së Deleguar (BE) 2015/560. Numri CELEX 32018R0273, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 58, datë 28.2.2018, f .1-59.

Shtojca I

WINE EXPORT CERTIFICATE
Chamber of Commerce and Industry

Place and date: 1. Serial No.
For wines exported from Republic of Albania to _____

This is a multi-purpose certificate, established in accordance with Article 40 of Law No.86/2022, used for:
Certificate of Origin, Certificate of Health and Certificate of Authenticity

2. Consignor: 2a. Identification:		3. Exporter: 3a. Identification:
4. Place of dispatch		
5. Identity of means of transport (nature):		5a. Reference
6. Importer		7. Place of delivery
8. Description		
9. Quantity (Liters):	If packaged product	10. Volume of containers (liters): 11. Number of containers:

12. Certification:
We, undersigned, responsible for these products for export, certify the following information:
The products listed above were produced and bottled in the Republic of Albania.
All the products comply with the provisions governing the production and release of products for direct human consumption under Albanian law;
The products were produced by normal and approved methods of production and not specifically for the purpose of export and the products are authentic and are fit for human consumption in Albania.
The products listed above were produced and bottled under Albanian rules as wines with:
❑ *Protected designation of origin (PDO) or Protected geographical indication (PGI) registered in the register referred to in Article 21, point 6 of Law Nr.86/2022*
❑ *Indication of the vintage year in accordance with the rules provided for in Article 36 of Law Nr.86/2022*
❑ *Indication of the wine grape variety(ies) ('varietal wines') in accordance with the rules provided for in Article 36 of Law Nr.86/2022.*
Complementary certification (optional)

13. Competent Authority responsible for checking the consignor at the place of dispatch: NATIONAL FOOD AUTHORITY, Bulevardi "Zogu i Parë", Njësia Administrative Nr.9. Tiranë,
e-mail: info@aku.gov.al, web: www.aku.gov.al.

14. The consignor Signature: Date: Name and title:	15. The Chamber of Commerce and Industry official Signature and stamp: Date: Name and title:

Shtojca IA

Rubrikat e Certifikatës së eksportit	**Shpjegime**
1. Serial No. (Numri serial)	Numri unik i vendosur nga Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë për dokumentin; kur është e zbatueshme, duhet të jetë numri serial i dokumentit shoqërues i referuar në Nenin 38 të ligjit nr. 86/2022
2. Consignor (Dërguesi)	Emri i plotë dhe adresa e plotë e dërguesit (*referuar dorëzuesi në ligj)*
2a. Identification (Identifikimi)	Numri identifikimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT) të dërguesit
3. Exporter (Eksportuesi)	Emri i plotë dhe adresa e plotë e eksportuesit nëse është i ndryshëm nga dërguesi
3a. Identification (Identifikimi)	Numri identifikimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT) të eksportuesit
4. Place of dispatch (Vendi nga ku dërgohet malli)	Vendi nga ku dërgohet malli nëse është i ndryshëm nga adresa e dërguesit
5. Identity of means of transport (nature): (Lloji i mjetit të transportit)	Lloji/natyra e transportit: kamion, anije, avion etj.
5a. Reference	Referenca e mënyrës/mjetit të transportit (emri i mjetit, numri i regjistrimit ose në rastin e anijeve emrin, të dhëna të tjera opsionale)
6. Importer (importuesi)	Emri i plotë dhe adresa e plotë e importuesit
7. Place of delivery (vendi i dorëzimit)	Adresa e dorëzimit, nëse malli nuk dorëzohet në adresën e importuesit
8. Description (Përshkrimi)	Informacionet e detyrueshme dhe jo të detyrueshme nëse parashikohen të shfaqen në etiketën e produktit sipas përcaktimeve në nenet 31 dhe 32 të ligjit nr. 86/2022
9. Quantity (Sasia në litra)	Sasia në litra
10. Volume of containers (Volumi i kontenierëve)	Volumi i kontejnerëve nëse produkti është i paketuar (nëse kanë të njëjtin volum)
11. No.of containers (Nr i konterinerëve)	Numri i kontejnerëve nëse produkti është i paketuar
12. Certification (Certifikimi)	Informacioni në lidhje me certifikatën e origjinës apo të prejardhjes, cilësinë dhe karakteristikat e produktit të verës, të cilat përcaktohen nga grupi i prodhuesve, viti i vjeljes apo varieteti/varietetet e rrushit nga të cilët është prodhuar, dhe EOM-ja apo TGJM-ja, kur kërkohet, përfshirë referencën për certifikatën për EOM-në ose TGJM-në sipas nenit 39, pika 1 të ligjit nr. 86/2022
14. The consignor (Dërguesi)	Emri, Mbiemri, Firma e dërguesit dhe data e nënshkrimit
15. The Chamber of Commerce and Industry official (zyrtare i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë)	Emri, Mbiemri, Firma e zyrtarit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe data e nënshkrimit

Shtojca II

VI-1 DOCUMENT FOR THE EXPORT OF WINE, GRAPE JUICE OR GRAPE MUST FROM REPUBLIC OF ALBANIA INTO THE EUROPEAN UNION

<table>
<tr><td>1. Exporter (name and address):</td><td colspan="2">2. Serial No:</td></tr>
<tr><td>3. Consignee (name and address):</td><td colspan="2">4. Customs stamp (for official EU use only)</td></tr>
<tr><td>5. Means of transport and transport details:</td><td colspan="2">6. Place of unloading (if different from 3):</td></tr>
<tr><td colspan="3">7. Description of the imported product:</td></tr>
<tr><td>8. Quantity (Liters):</td><td rowspan="2">If packaged product</td><td>9a. Volume of containers (liters):
9b. Number of containers:</td></tr>
<tr><td colspan="3">10. CERTIFICATE
The product described above ❑ is/ ❑ is not intended for direct human consumption, complies with the Union definitions or categories of grapevine products and has been produced using oenological practices

❑ recommended and published by the OIV/ ❑ authorised by the Union.

Full name and address of the competent body: Place and date:
NATIONAL FOOD AUTHORITY, Bulevardi “Zogu i Parë”, Njësia Administrative Nr.9. Tiranë

Stamp: Signature, name and title of the official:</td></tr>
</table>

11. ANALYSIS REPORT (describing the analytical characteristics of the product described above)
FOR GRAPE MUST AND GRAPE JUICE

— Density:

FOR WINE AND GRAPE MUST STILL IN FERMENTATION

— Total alcoholic strength: — Actual alcoholic strength:

FOR ALL PRODUCTS

— Total dry extract: — Total sulphur dioxide:

— Total acidity: — Volatile acidity: — Citric acidity:

Full name and address of the designated body or department (laboratory):

Stamp: Place and date:

Signature, name and title of the official:

Put an "X" in the appropriate box

Attribution (entry into free circulation and issue of extracts)

Quantity	12. No and date of the customs document of release into free circulation and of the extract	13. Full name and address of the consignee (extract)	14. Stamp of the competent authority
Available			
Attributed			
Available			
Attributed			
Available			
Attributed			
Available			
Attributed			

15. Other remarks

Shtojca IIA

Rubrikat e certifikatës	**Shpjegime**
1. Exporter (Eksportuesi)	Emri dhe adresa e plotë në Shqipëri e eksportuesit
2. Serial No. (Numri serial)	Numri serial unik i vendosur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për dokumentin; kur është e zbatueshme, duhet të jetë numri serial i dokumentit shoqërues i referuar në Nenin 38 të ligjit nr. 86/2022
3. Consignee: (Marrësi)	Emri i plotë dhe adresa e plotë e marrësit (*referuar si marrësi në ligj)*
4.Customs stamp (for official EU use only) Vula e doganës	Hapësirë e rezervuar për zyrtarë të doganës
5. Means of transport and transport details (Lloji transportit dhe detaje e tij)	I referohet vetëm transportit në pikën e hyrjes në Bashkimin Evropian. Specifiko llojin (anije, avion, kamion etj.) dhe shëno emrin/kodin e mjetit (nëse ka).
6. Place of unloading (if different from 3) (Vendi i shkarkimit)	Vendi i shkarkimit të mallit nëse është i ndryshëm nga adresa e marrësit të referuar në pikën 3 në këtë tabelë.
7. Description of the imported product (Përshkrimi i produktit të importuar)	Informacionet e detyrueshme dhe ato jo të detyrueshme nëse parashikohen të shfaqen në etiketën e produktit, në përputhje me nenet 31 dhe 32 të ligjit nr. 86/2022
8. Quantity (Liters) (Sasia në litra)	Sasia në litra
9a. Volume of containers (Volumi i kontenierit)	Volumi i kontejnerëve nëse produkti është i paketuar (nëse kanë të njëjtin volum)
9b. No. of containers (Nr.Kontenierëve)	Numri i kontejnerëve nëse produkti është i paketuar
10. Certificate (Certifikimi)	Shënohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kutitë që përputhen me certifikimet e produktit në përputhje me nenin 39 pika 1 të ligjit nr. 86/2022.
11. Analysis report (Raporti analizave)	Shënohen karakteristikat analitike të produktit të përshkruar më sipër dhe firmoset dhe vuloset nga personi përgjegjës në njërin nga laboratorët e autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Pikat 12, 13, 14 dhe 15	Për tu plotësuar nga zyrtarë të Bashkimit Evropian.

URDHËR
Nr. 829, datë 25.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E LETONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Kurzemes	Tukuma	Džūkstes*
Kurzemes	Talsu	Ģibuļu*
Vidzemes	Madonas	Cesvaines*
Vidzemes	Madonas	Kalsnavas*
Vidzemes	Valkas	Ērģemes*
Zemgales	Bauskas	Iecavas*
Zemgales	Dobeles	Tērvetes*
Zemgales	Jelgavas	Glūdas*
Zemgales	**Bauskas**	**Dāviņu***
Rīgas	**Mārupes**	**Babītes***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët**:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik**:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të

Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që**:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që**:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që**:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që**:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që**:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 797, datë 14.8.2025 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Letonisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 830, datë 25.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e. nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
4	Podlaskie	Białystok	Łapy*
5	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
6	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
7	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
8	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
9	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Ilowo-Osada*
10	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
11	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
12	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
13	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
14	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
15	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
16	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
17	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
18	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
19	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
20	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
21	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
22	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
23	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
24	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
25	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
26	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
27	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
28	**Podkarpackie**	**Mielec**	**Radomyśl Wielki***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 2.

6. Urdhri nr. 799, datë 14.8.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

8. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 837, datë 28.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë

29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht, me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Lubelskie	Biała Podlaska	Janów Podlaski*
Lubelskie	Radzyń Podlaski	Czemierniki*
Lubelskie	Biłgoraj	Tarnogród*
Lubelskie	**Hrubieszów**	**Dołhobyczów***
Lubelskie	**Tomaszów Lubelski**	**Ulhówek***
Pomorskie	Wejherowo	Luzino*
Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
Zachodniopomorskie	Choszczno	Recz*
Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
Zachodniopomorskie	Stargard	Chociwel*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik, të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose në nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe

janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 798, datë 14.8.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 838, datë 28.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3***
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Vito d' Asio*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Sequals*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sotto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Attimis*
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Arta Terme***
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Cividale Del Friuli***
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Chiusaforte***
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Comeglians***
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Paluzza***
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Ravascletto***
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pontebba*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Moggio Udinese*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Prepotto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Grimacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paularo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pagnacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Artegna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Leonardo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Daniele Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Forgaria Nel Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Faedis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Savogna*

Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ragogna*
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Antey-Saint-André*
Valle d'Aosta	Aosta	Arvier*
Valle d'Aosta	Aosta	Arnad*
Valle d'Aosta	Aosta	Ayas*
Valle d'Aosta	Aosta	Aymavilles*
Valle d'Aosta	Aosta	Bard*
Valle d'Aosta	Aosta	Bionaz*
Valle d'Aosta	Aosta	Brissogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Brusson*
Valle d'Aosta	Aosta	Charvensod*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*
Valle d'Aosta	Aosta	Champorcher*
Valle d'Aosta	Aosta	Chamois*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Victor*
Valle d'Aosta	Aosta	Cogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Emarèse*
Valle d'Aosta	Aosta	Fénis*
Valle d'Aosta	Aosta	Fontainemore*
Valle d'Aosta	Aosta	Gignod*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressan*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressoney-Saint-Jean*
Valle d'Aosta	Aosta	Hone*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Pontey*
Valle d'Aosta	Aosta	Pollein*
Valle d'Aosta	Aosta	Roisan*
Valle d'Aosta	Aosta	Rhemes-Saint-Georges*
Valle d'Aosta	Aosta	Nus*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Issogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Issime*
Valle d'Aosta	Aosta	La Salle*
Valle d'Aosta	Aosta	Jovençan*
Valle d'Aosta	Aosta	Lillianes*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Christophe*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Marcel*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Nicolas*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Vincent*
Valle d'Aosta	Aosta	Torgnon*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrès*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;*

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;*

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me

rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.*

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore,* për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore,* sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.*

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 823, datë 21.8.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 839, datë 28.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ESTONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe

ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Rapla	*Kehtna*	*Kehtna-Nurme**
Tartu	*Mäksa*	*Sudaste**
Tartu	*Tartu*	*Väägvere**
Tartu	*Tähtvere*	*Ilmatsalu (Alevik)**
Viljandi	*Kolga-Jaani*	*Vissuvere**
Viljandi	*Abja*	*Veskimäe**
Viljandi	***Tarvastu***	***Anikatsi****
Viljandi	*Tarvastu*	*Kannuküla**
Viljandi	***Viiratsi***	***Mäeltküla****
Põlva	*Valgjärve*	*Sulaoja**

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Estonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara in vivo të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së

murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 809, datë 15.8.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të

derrave, të shfaqur në shtetin e Estonisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 840, datë 28.8.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Kroacisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Karlovacka	**Ozalj***	
Krapinsko-Zagorska	**Zagorska Sela***	
Istarska	**Buzet***	
Istarska	**Cerovlje***	
Istarska	**Gračišće***	
Istarska	**Karojba***	
Istarska	**Kaštelir-Labinci***	
Istarska	**Marčana***	
Istarska	**Pazin***	
Istarska	**Pićan***	
Istarska	**Višnjan***	
Istarska	**Vižinada***	
Istarska	**Žminj***	
Licko-Senjska	**Brinje***	
Licko-Senjska	**Gospić***	
Licko-Senjska	**Senj***	
Licko-Senjska	**Perušić***	
Licko-Senjska	**Vrhovine***	
Primorsko-Goranska	**Malinska-Dubašnica***	
Primorsko-Goranska	**Vrbnik***	
Primorsko-Goranska	**Vrbovsko***	
Splitsko-Dalmatinska	Vrlika*	

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me

rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore,* për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 743, datë 30.7.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Kroacisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1030, datë 2.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Kompetencat e deleguara nga ministri tek sekretari i përgjithshëm, delegohen tek z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për periudhën 3.9.2025 deri më 10.9.2025.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Sokol Ismaili, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 1031, datë 2.9.2025

PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTEVE NË EMËR TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Z. Sokol Ismaili, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, që në mungesë dhe me porosi, të zëvendësojë për nënshkrimin e korrespodencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Gjatë periudhës së zëvendësimit, të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-aktet*, në emër dhe për llogari të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Gjatë periudhës së zëvendësimit të nënshkruajë elektronikisht, në emër dhe për llogari të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në sistemin AFMIS dhe miratimin në sistemin SIFQ.

4. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për periudhën 3.9.2025 deri më 10.9.2025.

5. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Sokol Ismaili, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Llambriola Misto

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/09/04 15:07:27 +02'00'
3bb1bde7f6354796b1c3b59dfdbc1261202509041
5071776031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)